ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE & KULTURORE

Themelues BUJAR HUDHRI
Kryeredaktore VIOLETA MURATI

E SHTUNË, 15 QERSHOR 2019. NUMËR 31. VITI I I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Mirela Oktrova, gazetarja që 20 vjet më parë raportoi për Europën nga kampet e refugjatëve në Maqedoni dhe hyri me forcat e NATO-s në Kosovë, është vlerësuar nga Shoqata e Botuesve të Kosovës në kuadër të Panairit të Librit, Prishtinë 2019, me Çmimin e Publicistikës

MIRELA OKTROVA

Fotot unike dhe ditari që u shkrua në netët e luftës së Kosovës, pas raportimit për Perëndimin



Portreti nga Ina Lajthia

PANAIRI I LIBRIT NË PRISHTINË, SPROVA ME LEXUESIT

(fq. 13)

Mediat franceze shkruajnë mbi botimin e romanit "Valsi i lumturisë"

"VALSI I LUMTURISË" I YLLJET ALIÇKAJT, NJË ROMAN SHKRUAR ME MENÇURI DHE HUMOR TË ZI

nga Jean-Paul Champseix

(fq. 6)

Botohet vepra e plotë

LAZËR RADI ZBRET N'PRISHTINË!

nga Agron Gashi

(fq. 11)

"Historia e Artit Shqiptar 1858-2000" një libër studimor nga Ermir Hoxha (Fq. 12)

"Mes reales dhe surreales" shënime për librin "Lutjet e mesnatës" të K. Mehmetit nga Majlinda Rama (Fq. 10)

Forumi "Botimet shqipe në Malin e Zi", në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, në bashkëpunim me Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Malit të Zi Fq. 12)

EKSPOZITA

PREJ TE MARUBI PËRTEJ MARUBIT: TRADITA E ARTIT FOTOGRAFIK TE NE

nga Ardian Ndreca

(Fq. 5)

SAMANTA SCHWEBLIN ZBULOJ ERRËSIRËN PËRMES LETËRSISË

Intervistoi Bethanne Patrick

(Fq. 14)

BIBLIOTEKË

Mirela Oktrova, gazetarja që 20 vjet më parë raportoi për Europën nga kampet e refugjatëve në Maqedoni dhe hyri me forcat e NATO-s në Kosovë, është vlerësuar nga Shoqata e Botuesve të Kosovës në kuadër të Panairit të Librit, Prishtinë 2019, me Çmimin e Publicistikës. "55 ditë" quhet albumi-ditar, botimet "Onufri", 20 vjet pas çlirimit të Kosovës, si dokumentim dhe dëshmi e së shkuarës së afërt jo vetëm përmes rrëfimit, por duke u shoqëruar me foto unike nga zona e krizës, kur çdo ditë me mijëra shqiptarë të Kosovës evakuoheshin drejt Perëndimit

MIRELA OKTROVA

FOTOT UNIKE DHE DITARI QË U SHKRUA NË NETËT E LUFTËS SË KOSOVËS, PAS RAPORTIMIT PËR EUROPËN

Intervistoi: Violeta Murati

Libri juaj, apo më mirë albumi-ditar nga lufta e Kosovës, është vlerësuar në Panairin e Librit 2019, në Prishtinë, me Çmimin e Publicistikës. Para se t'ju pyesja konkretisht rreth këtij projekti, doja të dija se si e shihni rolin e medias, sidomos raportimet nga zonat e krizës apo nga fronti i luftës... Në Shqipëri, me sa dimë, ju jeni e vetmja gazetare që e keni bërë këtë.

Në periudhën së cilës i referohem në ditarin tim, kam qenë gazetarja e vetme shqiptare në zonën e krizës dhe e para gazetare që më 12 qershor 1999 hyri me trupat e NATO-s në Kosovë. Nisur nga përvoja ime e gjatë si gazetare dhe veçanërisht nga përvoja si reportere lufte, them se profesioni i gazetarit, pavarësisht se në kohë lufte apo paqeje, është baras me përgjegjësi. Po nëse në kohë paqeje informimi duhet të jetë i përgjegjshëm, pasi prej tij varet orientimi shoqëror i secilit prej individëve që shërbehet me të, në kohë lufte nga përgjegjësia e informimit varet jeta e gjithsecilit që e merr këtë informacion. Nuk marr dot përsipër të them me siguri nëse jam e vetmja që kam qenë në një pozicion të tillë, ndonëse në dijeninë time po. Por për mua, më shumë rëndësi se të qenit në zonën e luftës, kanë rëndësi mësimet që gjithsecili nxjerr prej një përvoje të tillë. Dhe sipas meje, veçanërisht për një treg informacioni si yni, është jetike të mos kesh nevojë të kesh qenë në luftë për t'u bërë i përgjegjshëm në paqe...

Ditari ofron informacion të dorës së parë, me një fokus të përcaktuar, ngjarjet e të cilit nisin në pashkën e vitit 1999, kur bota u përball me një eksod masiv të shqiptarëve të Kosovës... Ka një histori vendimi që morët për t'u nisur në zonën e krizës në Maqedoni?

Duke qenë se punoja për seksionin shqip të radios Dojçe Vele, pra për një redaksi lajmesh që informonte disa herë në ditë për rajonin, isha gjithsesi e lidhur profesionalisht dhe emocionalisht shumë ngushtë me ngjarjet. Por në epiqendër të tyre më vuri një zhvillim i një natyre tjetër... Të dielën e pashkëve nga Ministria e Brendshme e RFGJ-së më ofruan të shoqëroj si eksperte për rajonin misionin e posaçëm që do të evakuonte të shpërngulurit e Kosovës nga Maqedonia në Gjermani. Misioni gjerman – i pari i këtij lloji – synonte të bëhej model për vendet e tjera perëndimore. Nuk hezitova të pranoja, me gjithë përgjegjësinë ndaj vajzës dhe prindërve, por nuk mund të bëja ndryshe... Nuk ishte as turizëm lufte dhe as aventurizëm, por thjesht nuk munda të refuzoja... Drama njerëzore që unë, si gazetare e lidhur shumë ngushtë me rajonin, e dija se si kulmonte çdo ditë e më frikshëm në Kosovë, nuk më linte të bëja sehir...



"E Premte e Madhe, 2 prill 1999..." dhe më pas "Misioni i parë: Pashkë në Bllacë..." Kështu e nisni ditarin... Ka ndonjë prapamendim, apo është kjo rastësi për ju? Në çfarë besuat në ato momente?

Fillimi i ditarit dhe përjetimeve të paraqitura në të është i diktuar nga historiku i ngjarjeve apo nga aktualiteti i dikurshëm. Ndonëse shpesh eksodit kosovar të vitit 1999 i vihet epiteti "biblik", jo gjithkush e di se ishte pikërisht e Premtja e Madhe e Shenjtë e Pashkës 1999 dita që shënoi kulmin e emergjencës së refugjatëve në brezin asnjanës të pikës kufitare të Bllacës dhe e Diela e Pashkëve ajo që sensibilizoi opinionin ndërkombëtar për dramën humanitare të shqiptarëve të Kosovë, që kishin kohë që endeshin brenda Kosovës, por që atë ditë mbërritën me qindra mijëra në kufi, duke u bërë më në fund të perceptueshëm për botën. Në momentin kur unë u bëra pjesë e misionit, besoja se njerëzve u duhej ardhur në ndihmë me çdo kusht dhe se askush të cilit i jepej mundësia për ta bërë këtë, nuk mund të shmangej, pavarësisht pasojave që në atë moment nuk ishin të parashikueshme.

Ju raportonit për Dojçe Vele-n, RTSH-në dhe media të tjera gjermane. Ndërsa raportimi kërkon një gjendje "të akullt" apo neutral për të komunikuar vetëm faktet, të vërtetën, sa e mundur është kjo, kur raportohet nga zona e krizës apo fronti i luftës, kur pamjet tragjike janë përballë. A kujtoni ndonjë episod lidhur me këtë?

Fatmirësisht, dita dhe nata ime e punës ishte e organizuar në mënyrë të tillë, që më jepte mundësinë të ndaja veprimtarinë time në mbështetje të të shpërngulurve, çka ndodhte në kuadrin e misionit gjerman për evakuimin e tyre nga Maqedonia, nga pozicioni i reporteres së fokusuar te faktet. Ndonëse angazhimi im parësor në rajon kishte të bënte me misionin e evakuimit dhe angazhimin tim si eksperte dhe përkthyese në kuadrin e procedurave përkatëse, raportoja mesatarisht gjashtë herë në ditë *live* për mediat audiovizive gjermane dhe shqiptare. Të gjitha emocionet dhe mbresat e tjera që nuk arrija t'i përpunoja dot gjatë ditës, mundohesha t'i hidhja në ditarin që mbaja pasditeve dhe mbrëmjeve, si një mënyrë për t'u "larë" borxhin të gjithë atyre që nuk kishin gjetur dot vend në raportimet e mia ditore. Episodi më mbresëlënës përkitazi punës sime si reportere i takon një dite kur, ndryshe nga herët e tjera kur unë, për të shmangur ndërprerjen e linjës dhe ndërhyrjen e zhurmave, informoja nga automjetet e grupit, për shkaqe logjistike u detyrova të raportoja direkt nga kampi, ku prej pak ditësh ishte instaluar një altoparlant, nëpërmjet të cilit banorët e kampit mund të ndiqnin programet e Dojçe Vele-s në shqip.

Kështu, tek informoja për programin e mesditës, u bëra papritur e ndërgjegjshme se zëri që momentalisht vinte nga altoparlanti, ishte zëri im, dhe reagimet e atyre që dëgjonin kishin të bënin me ato që po thosha unë. Tek shihja me sa vëmendje më dëgjonin, desh u stepa dhe efekti i atyre që po thosha nisi të më trembë. Ndikimi i medias te publiku i vet nuk ishte i panjohur për mua – po deri në atë çast e kisha njohur thjesht teorikisht e profesionalisht, pa e provuar praktikisht. Të paktën jo në këtë formë dhe me këtë mprehtësi. Se vetëm në atë çast pashë me sytë e mi se si nga çdo fjalë që unë thosha, varej jeta e atyre që më dëgjonin... nëse unë informoja që mbrëmjen e shkuar kishte kaluar kufirin edhe një kontingjent i ri të dëbuarish, secilit prej tyre i ringjallej shpresa se në të mund ishte nëna, babai, vëllai, motra, të dashurit e vet, të humbur prej muajsh... nëse njoftoja se kufiri ishte mbyllur, kjo për ta do të thoshte ankth i tmerrshëm për gjithë ç'mund t'u ndodhte atyre që kishin mbetur të mbyllur në anën e vdekjes... po kështu, nëse flisja për bombardime, për evakuime, për masa mbështetëse apo për ndihma nga komuniteti ndërkombëtar... Ndërsa flisja dhe ndiqja reagimin e dëgjuesve të mi, për herë të parë mendova se lufta dhe krizat me sfond ekzistencial janë përvoja nga duhet të kalojë të paktën një herë në jetë çdo gazetar, për të kuptuar se nga pena, fjala dhe reagimet e tij varet jeta e të tjerëve, aq më shumë në anët tona, ku gazetaria nuk është sfidë përgjegjësie.

A është ky album-ditar një plan paraprak? Pse gjithë kjo distancë kohe dhe pritjeje për të parë dritën e botimit?

Ideja për publikimin e këtyre materialeve ka "moshën" e vetë dëshmive që këto materiale zbulojnë. Edhe vendimi për të pritur gjithashtu. Ngjarje si këto shënjojnë kombin, shoqëritë, mediat, njerëzit... Në një drejtim a në një tjetër. Fatkeqësisht, më shpesh në një tjetër nga ai i pritshmi... Në këndvështrimin tim, shoqëria jonë dhe media, si pjesë e saj, janë tejet problematike në mënyrën se si raportohen me ngjarje të këtij lloji. Pasi marrëdhënia me to është e pandarë nga përdorja apo më saktë nga keqpërdorja e tyre – për karrierë, për protagonizëm apo për pushtet. Ndaj unë me qëllim vendosa të prisja. Për të ndenjur në mënyrë të ndërgjegjshme larg këtij trendi, paçka se ideja jetonte me mua në gjithë këto vite. Dhe prita... Derisa të gjitha dëshmitë e tjera, jo të drejtpërdrejta dhe mbase edhe jo autentike, u konsumuan, protagonizmat e të gjitha llojeve verifikuan synimet, duke e justifikuar vetveten ose jo, dhe interesat – të paktën ato afatshkurtra dhe afatmesme – shteruan. Atëherë mendova se kishte kaluar "koha e rrekjes së madhe për lavdi" dhe u kishte ardhur radha dëshmive autentike dhe së vërtetës, së vërtetës së jetuar me të vërtetë.

Kur para rreth shtatë vjetësh hapa në Tiranë ekspozitën "Fate lufte", e kisha vendosur me vetveten që këtë dokumentacion t'ia dhuroja Kosovës në pesëvjetorin e pavarësisë. Po më takonte që këtë rrugëtim ta nisja nga Shqipëria. Në respekt të aktit të pashembullt të solidaritetit që populli shqiptar i këtejkufijve tregoi në mbështetje të të shpërngulurve nga Kosova. Po edhe në plotësim të kujtesës dhe njohurive të tyre me atë dimension të dramës që kishte qenë jashtë perceptimit dhe kufijve shqiptarë. Interesi me të cilin ekspozita u prit nga publiku tiranas dhe jehona që ajo pati në media, më bindi se vendimi për ta filluar nga Shqipëria kishte qenë i drejtë. Aq më shumë më dhembi indiferenca e përfaqësisë së atëhershme të Republikës së Kosovës në Tiranë dhe pamundësia e realizmit të synimit tim për ta çuar ekspozitën në Kosovën protagoniste... në pesëvjetorin e saj të pavarësisë. Po për fat jeta vazhdon... Dhe historia bën përpara... Kosova festoi dhjetëvjetorin e "ditëlindjes" së saj dhe një tjetër jubile, i lidhur drejtpërdrejt me këto dëshmi, u shënua këto ditë kur unë, më në fund, arrita ta sjell librin në Prishtinë, duke plotësuar kështu jo vetëm premtimin që i kisha dhënë vetes, por dhe detyrimin ndaj Kosovës që ushqeu mbresat dhe faktet që libri përmban.

Fotot, pa dyshim, janë mbresëlënëse, tronditëse... Si nisët t'i bënit ato fotografi? A ka foto ose pjesë rrëfimi të lëna jashtë, apo gjithçka është e përfshirë në "55 ditë"?

Fotografitë që shoqërojnë rrëfimin, nuk janë fotografi artistike, madje as produkt i një plani paraprak. Edhe sot nuk jam në gjendje të shpjegoj se si nisa t'i bëja ato fotografi. Në mendje më ka mbetur vetëm dëshira për të mos u "ndarë" prej portreteve që ato fiksojnë. Ndaj këto foto-dëshmi janë shkrepur shpejt, me ndjesinë e momentit, dhe fillimisht nga larg, për të mos lënduar të fotografuarit dhe për të mos prodhuar ndjesinë se vuajtja e tyre po përdoret. Derisa ata – me të parë aparatin fotografik – zunë vetë të afrohen dhe të kërkojnë të fotografohen. Disa për të fiksuar, qoftë dhe virtualisht, ekzistencën prej muajsh të pasigurt, të tjerë për të lënë gjurmë jete në një rrugëtim, ku jo një herë ishin ndier të humbur. Ndaj fotot e mia fiksojnë të moshuar që i ktheheshin aparatit me ndjesinë e ndarjes nga jeta, fëmijë, prindërit apo të afërmit e të cilëve më shtynin t'u fiksoja fytyrat si dëshmi ekzistence, dhe cilindo tjetër që "takimin" me aparatin fotografik e shihte si vëmendje dhe mundësi për të rimarrë fytyrë në një veçim sado të shkurtër nga masa shumëvuajtëse që e shndërronte në numër. Fiksimi i identiteteve në celuloid më shkaktoi, megjithatë, një lloj stepjeje etike, veçanërisht vitet e ushtrimit të profesionit në Gjermani do më kishin shtyrë në çdo rast tjetër të tentoja të dokumentoja miratimin e "heronjve" të mi për t'u fotografuar, por në kushtet kur kufiri kalohej me një vulë në dorë dhe njerëzit e konsideronin foton si amanet, plotësimin e vullnetit të tyre të fundit në tokën, që po linin, e pashë si detyrim. Një detyrim të plotësuar vetëm përgjysmë deri ditën e botimit të këtij libri, kur dëshmia e tyre të arrijë lexuesin.

Fotot janë, në fakt, shumë më tepër se ato të paraqitura në këtë album – ato janë afro 500. Po unë këtu kam paraqitur ato që flasin më shumë, ndërkohë që materiali i shkruar është ofruar në mënyrë shteruese.

Ç'domethënie ka fotoja e kopertinës dhe të tjera foto në album, ku shihen vula dhe numra identifikimi mbi duar refugjatësh, çka ngjall trishtim, të kujton holokaustin, por, në fakt, ka shërbyer për të shpëtuar dhe jo për të shfarosur jetë. Ju ishit e angazhuar drejtpërdrejt në këtë "numërim"? Si e shihnit këtë procedurë?

Në mungesë të dokumenteve të identifikimit dhe vizës, secili prej të shpërngulurve merr në dorë një vulë, akronimin e Ministrisë së Brendshme gjermane, dhe një numër që e identifikon. Praktika, me reminishencë të fortë me kampet e dikurshme naziste të përqendrimit, komentohet në shtypin gjerman si "cenuese" për dinjitetin njerëzor, dikush shkon deri aty sa të propozojë madje ndalim dhe deri kërkim ndjese për përdorimin e saj. Vetë të shpërngulurit e trajtojnë me kujdes si "vulën e shpresës", lirojnë dorën e vulosur nga gjithë ç'kanë me vete dhe përpiqen ta mbajnë disi më lart, për ta ruajtur se mos u fshihet. Ndërsa mua, përsëritja e së njëjtës praktikë në kushte dhe me motive të ndryshme më ngjan si një lloj katarsisi. Fundja, njeriu – me mënyrën se si i përdor – është ai që u vesh objekteve domethënie, sikurse dhe këtij numri identifikimi, përdorimi i të cilit sot ndryshon historinë shumëvjeçare të lidhjes së njeriut me numrin, duke kuruar simbolikën e përndjekjes, të cilën këtë herë nuk e mbjell, por e shmang.

Përmes fotove ju sillni pamje autentike të dramës së të shpërngulurve nga Kosova. Me çfarë u përballët më pas? Çfarë keni ndier dhe perceptuar nga të gjitha këto trazime?

Misioni ynë evakuoi 15 mijë vetë drejt Gjermanisë. Kur ktheva kurrizin për të ikur, duke lënë pas gjithë atë anonimat të madh vuajtjesh dhe sakrificash, ndjeva se doja t'i mbaja mend të gjithë... të gjithë ata që, kur ngjarjet e ditës mbysnin qetësinë e natës, as më largoheshin dhe as u largohesha dot nga mendja dhe sytë. Ato fate të nëpërkëmbura nga lufta, të mpakura nga drama humanitare, të lëna pas dore nga lajmet e frontit, statistikat dhe strategjitë, e dija se do të vazhdonin të më emociononinin sa herë t'u rikthehesha shënimeve të atyre kohëve, kur natën e shkurtonte halli dhe gjumin e zbonin mbresat. Pas kisha lënë një pjesë të shpirtit tim, të ngjizur në mijëra emra dhe fate që s'më ndaheshin, duke më rithënë për herë të 15001-të se lufta është dhimbja më e madhe që njerëzimi mund t'i shkaktojë vetvetes, por edhe mësimi më i madh që jeta mund t'i japë njerëzimit! Dhëntë Zoti, të mos përjetojmë luftën, për të mësuar të vlerësojmë paqen! Me këto mendime dhe mbresa – herë më intensive dhe herë më pak – kam jetuar deri sot, kur për herë të parë kam ndjesinë se u kam "larë atyre borxhin" që u kisha për t'u rikthyer kujtimet dhe mbresat me të cilat më ngarkuan atëherë.

Në gjithë këtë histori rrëfimi Shqipëria nuk është në fokus. Përse?

Drama e të shpërngulurve nga Kosova, pa dyshim, është shumë më e madhe, shumë më e gjerë dhe shumë më e thellë nga sa më panë sytë e më dëgjuan veshët mua në Maqedoni dhe pjesërisht në Kosovë. Një nga kapitujt më tronditës të saj – nëse jo më tronditësi – është Golgota shqiptare e qindra mijëra të dëbuarve kosovarë dhe po aq të pakamurve shqiptarë që ndanë me ta gjithë ç'kishin e ç'nuk kishin.

Po Shqipëria nuk është në fokusin tim, sepse unë nuk kam qenë dëshmitare e drejtpërdrejtë e asaj drame, por edhe sepse drama që përditë "luhej" para syve të mi, ma mbërthente vëmendjen pas vetes deri në atë shkallë, sa më "mbyllte" çdo hapësirë perceptimi për "gjithçka" tjetër. Megjithëse, për shkak të afërsisë me luftën dhe kulisat e vendimmarrjes europiane për eksodin kosovar, kam ndier dhe perceptuar si rrallëkush të gjitha trazimet, që situata, por dhe mënyra e menaxhimit të saj nga qeveria shqiptare e kohës, prodhoi për vendin, shqiptarët e Shqipërisë dhe jo së fundi për miqtë e qindramijtë, që strehoheshin atëherë në të. Ndaj qasja ime ndaj zhvillimeve të kohës në Shqipëri është e ftohtë, analitike dhe ndodh të perceptohet si "e akullt".

Ky rrëfim ka shmangur totalisht politikën. Pse?

Ky rrëfim qëndron me vetëdije të plotë larg politikës, pavarësisht se herë pas here analizon ngjarje dhe rrethana të lidhura pashmangshmërisht me të. Analizat mbajnë vulën autentike të perceptimit të atëhershëm të të gjitha ngjarjeve dhe personazheve në fokus, duke mbetur besnike të synimit për të "fotografuar" gjithçka: jo vetëm ngjarjet, personazhet dhe rrethanat në të cilat ata veprojnë, por edhe qasjet e gjithkahshme të kohës ndaj tyre dhe anasjelltas. Ballafaqimi i së shkuarës me të sotmen politike të Kosovës i lihet qëllimisht gjykimit të lexuesit, duke përmbushur kështu një prej synimeve që një botim i tillë me karakter dokumentues mëton të përmbushë.

Brenda kësaj qasjeje, rrëfimi nuk pretendon as të japë një tablo shteruese të situatës, ndonëse ofron informacion të dorës së parë dhe përpiqet të mos mbetet rob i kohës dhe hapësirës që percepton, megjithëse fokusi i tij është qartësisht i përcaktuar. Ngjarjet e tij nisin në pashkën e vitit 1999, kur bota u përball për herë të parë me eksodin masiv të shqiptarëve të Kosovës, dhe përfundojnë një javë pas dislokimit të trupës ndërkombëtare të paqes në Kosovë, kur të shpërngulurit, po aq masivisht sa ikën, zunë të rikthehesh in në atdheun që ende digjej.

Sulmet ajrore të NATO-s, veprimet luftarake të ushtrisë jugosllave dhe nismat ndërkombëtare për paqen, përbëjnë kulisën gjigante të shpërnguljes masive drejt Maqedonisë, ngjarjes kryesore të këtij rrëfimi, dokumentuar në pamje po aq autentike sa ato, me të cilat u përballa unë gjatë dy misioneve evakuuese të qeverisë gjermane, pjesë e të cilave isha si eksperte e rajonit dhe gazetare. Afërsia me ngjarjet ka vulën e vet të fortë në qasjen time ndaj tyre dhe analizat që rrjedhin prej saj. Ndaj për të mos çorientuar lexuesin, ditari ndan qartësisht kronikën e zhvillimeve ndërkombëtare dhe rajonale nga kronika e shpërnguljeve dhe përjetimet e personazhit kryesor të rrëfimit, të lidhur ngushtë me to.

Ju rrëfeni jo për gjithë atë prani refugjatësh, duke tentuar të depërtoni në masë për t'iu shmangur humbjes së identitetit dhe identifikimit të njeriut me numrin. Megjithatë, heronjtë tuaj, siç shpreheni dhe vetë, janë të paemër. Si pajtohen këto qasje me njëra-tjetrën?

Rrëfimi mëton t'i shmanget edhe gjithëpranisë së masës shumëvuajtëse, fati i së cilës zapton pahiri vëmendjen time. Po ai "kundërshton" me vetëdije njësimin e njeriut me numrin. Fokusi i tij është tragjedia e individit, si i përndjekuri dhe vuajtësi më i madh i luftës. Sigurisht, me përjashtim të rasteve kur të vërtetat e masës janë më të forta se fati i secilit prej pjesëtarëve të saj. Heronjtë e mi janë, megjithatë, të paemër, portretet dhe situatat me të cilat ata përballen, vijnë në mënyrë përfaqësuese për të gjithë të ngjashmit e tyre që nuk arritën të shpëtonin, që u strehuan diku tjetër apo që unë nuk s'munda t'i takoja.

A keni një moment kulmor tuajin ku nuk mundët të realizoni raportimin tuaj, të cilin mund të na e rrëfeni në këtë intervistë?

Nuk ka pasur momente në të cilat nuk kam mundur të raportoj, por më kujtohet një moment në të cilin nuk kam mundur të fotografoj. Ditën e parafundit të misionit të parë, si për t'u ndarë nga zonat ku kishim evakuuar për dy javë rresht, rishkuam sërish në të gjitha kampet në kufi me Jugosllavinë, përfshirë dhe kampin e Radushës. Aty u përballa me 1.700 dëshmi të gjalla brenda kampit, por edhe mbi 1.000 të tjera jashtë tij, të cilat ndodheshin në pritje të kalimit të kufirit. Pamja më ringjethi për së pari. Tronditja kishte humbur koordinatë, rraskapitja thyente veç rekordet e vetvetes, ndërsa këputja kishte ngrirë në pritje të mundimeve akoma më të mëdha. Në atë dërrmim gjigant dinjiteti nuk munda të fotografoja, e ndodhur gjatë gjithë kohës nën vëzhgimin e një mijë fateve që në atë çast jetonin vetëm për të parë, në pritje të një shenje sado të vogël shprese se kufiri do hapet dhe ferri do mbesë pas. Për sa kohë s'bëja dot gjë për ta, mbeta e shtangur në respekt të vuajtjes së tyre.

Si e shikoni sot gazetarinë? A vazhdon media, sipas jush, të mbajë peshën e së vërtetës e të ketë impakt në ndërtimin e historisë për ne, është fjala atë shqiptare?

Unë bëj pjesë tek ata njohës dhe studiues të medias që nuk ndajnë mendimin e shumicës, sipas të cilit media bën pjesë në fushat më të zhvilluara të veprimtarisë shoqërore në Shqipëri. Është e vërtetë që mediat në Shqipëri thithin shumë investime, pjesa dërrmuese e të cilave shkon për teknologji. Por në këndvështrimin tim nivelin e zhvillimit të një medieje e përcakton, para së gjithash, përmbajtja dhe standardet e ofrimit të saj. Në kushtet kur burimet e financimit dhe interesat jotransparente që qëndrojnë pas tyre i bëjnë shumicën e mediave jo vetëm joobjektive dhe të paparashikueshme, por edhe të rrezikshme për manipulimin që ushtrojnë dhe çorientimin shoqëror që prodhojnë, "zhvillimi" që shumëkush sheh në to ka shkuar për mua në kah të kundërt. Në këto rrethana, gazetari e ka në dorë vetë nëse do të vendosë kundër apo pro së vërtetës, nëse do të zgjedhë të ecë sipas *status quo*-së apo do të tentojë ndryshimin, do të vijojë të mbetet pjesë e problemit apo do të tentojë të bëhet pjesë e zgjidhjes. Nisur nga ky këndvështrim, unë respektoj çdo personalitet gazetari që vetëdefinohet personalisht duke u distancuar nga modelet e konformizmit dhe të vërtetave të kapura nga interesat. Kjo është një rrugë dhe ndërmarrje e vështirë, por e vetmja e duhur dhe e drejtë e cila mund të funksionojë, nëse ata që vendosin për rrugën e dytë do të vijojnë të shtohen gjithnjë e më shumë, derisa situata të ndryshojë. Atëherë mund të fillojmë të diskutojmë si shoqëri hapur dhe pa komplekse si për të tashmen ashtu dhe për të shkuarën. Më parë, mendoj, kjo do të ishte energji e çuar dëm!

A janë të mjaftueshme dëshmitë e së kaluarës për të kuptuar të vërtetën? Çfarë e nxiti idenë tuaj për botim dhe tani, që e keni realizuar, çfarë mendoni se është e rëndësishme t'u tregohet brezave?

Unë besoj se monopolin e së vërtetës nuk e ka askush.Aq më tepër në kohë lufte dhe konflik-tesh, e vërteta është një mozaik, i pamundur të perceptohet pa të vërtetat. Ka disa të vërteta të të gjitha palëve. Unë ndihem e privilegjuar që me këtë botim më jepet mundësia të rrëfej të vërtetën time për gjithë ç'pashë dhe dëgjova në ato 55 ditë të qëndrimit tim në zonën e krizës dhe të luftës. Dhe kjo e vërtetë nuk vjen më kot tani.

Pikërisht në vitin e njëmbëdhjetë të pavarësisë dhe në 20-vjetorin e luftës, në kohë politikisht jo pak të trazuara, kur qasja ndaj së shkuarës bëhet gjithnjë e më koniunkturale, historia gjithnjë e më pak interesante dhe kujtimi i saj gjithnjë e më i parehatshëm, besoj se është më e rëndësishme se kurrë të risjellim edhe një herë në mend sakrificën stoike që populli kosovar i blatoi së ardhmes dhe marrëveshjen historike që Kosova lidhi atëherë me botën. Për të "shkundur" kujtesën, për të rizgjuar vetëdijen dhe jo së fundi, për të zgjuar përgjegjësi.

Shpresoj të ndajmë me lexuesin reflektimet që përballja me këto fakte nxit: për mua lufta mbetet sfida më e fortë ku njerëzimi provon veten, ndërsa paqja sprova e madhe që verifikon nëse sfida e luftës ka qenë e duhura dhe sa ajo ia ka vlejtur. Shpresoj fort që edhe lexuesi të mos mbetet larg kësaj qasjeje. Sepse pikërisht këtej merr jetë shtysa për të botuar këtë ditar dhe këto fotografi: jo vetëm për të risjellë në kujtesë sakrificat, por edhe për të tërhequr vëmendjen e njeriut për njeriun – që vërtet fiton përmes luftës – po fiton akoma më shumë përmes paqes. Natyrisht, për sa kohë di ta vlerësojë atë! Për të vlerësuar paqen, mjafton një luftë!

Cili do të jetë "udhëtimi" i këtij ditari-album pas prezantimit në Prishtinë?

Libri do të bëjë rrugën e tij të zakonshme. Do të vijojë paraqitja dhe pjesëmarrja në Panairin e Librit në Tiranë, Shkup, Malin e Zi dhe në panairet e tjera ndërkombëtare të librit. Në planet e mia bën pjesë edhe përkthimi në gjuhë të huaj, me synim ofrimin e tij një publiku akoma më të gjerë se ai shqipfolës.

Sa i rëndësishëm është profesioni i gazetarit nisur nga përvoja juaj (nëse gazetarinë mund ta quajmë profesion, se ka mendime të ndryshme për këtë)? Rasti juaj, p.sh., flet për një profesion si "mision"...

Unë besoj se profesioni i gazetarit, sikurse ai i mjekut, është njëkohësisht profesion dhe mision. Ndërsa mjeku ka në dorë shëndetin fizik të njeriut dhe e mëson njeriun si ta mbrojë atë, në këndvështrimin tim mediat dhe për pasojë gazetarët, kanë në dorë shëndetin mendor dhe orientimin shoqëror të të gjithë atyre që u drejtohen. Po në të dyja rastet, është shkalla e përgjegjësisë ajo që e bën profesionin të mbetet thjesht i tillë apo të ushtrohet edhe si mision.

PREJ TE MARUBI PËRTEJ MARUBIT:

TRADITA E ARTIT FOTOGRAFIK TE NE

nga Ardian Ndreca

Do të ishte e pafalshme me kalue në Shkodër në këtë periudhë dhe mos me vizitue ekspozitën "Fotografë të juglindjes shqiptare" të kujdesueme prej Gjergj Spatharit, e cila do të jetë e hapun deri me datën 27 tetor 2019 pranë Muzeumit Kombëtar të Fotografisë Marubi. Bahet fjalë për tetë fotografë, disa prej të cilëve pothuejse të panjohun, me origjinë nga Korça, Dardha, Opari, Voskopoja, Kolonja dhe Mborja. Artistat, veprat e të cilëve ekspozohen, janë Kristo Sulidhi (1859-1938), Petro Dhimitri (1886-1953), Perikli Kaçauni (1870-1940), Dhimitër Vangjeli (1872-1957), Vani Burda (1875-1949), Kristaq Sotiri (1883-1970), Thimi Raci (1886-1966) dhe Mandi Adhami Koçi (1912-1988).

Kjo ekspozitë nderon nji muzeum si Marubi, i cili ka frymë kombtare dhe promovon vlerat e artit të fotografisë në të gjithë hapsinën shqiptare. Përzgjedhja dhe kujdesimi i veçantë nga ana e Gj. Spatharit, bashkëpunimi i ngushtë me ente kombtare dhe lokale, me privatë dhe koleksionista kanë shenjue suksesin e kësaj nisme kulturore.

Ajo që i bashkon të gjithë këta pionierë të fotografisë asht fakti që e kanë përvetësue artin e fotografisë në emigracion, në Athinë, Stamboll, Odesë, Kajro, Bukuresht, SHBA. Megjithatë secili ka shpalosë talentin personal dhe ka përcaktue objektet e interesit të vet. Mes 125 fotove të ekspozueme, disa të shtypuna prej vetë autorëve e shumica të nxjerruna sot prej negativave në xham që kanë ardhë deri në ditët tona, gjejmë njerëz të thjeshtë e të panjohun, gra emigrantash që fotografohen për t'ia dërgue fotot bashkëshortëve në mërgim, funerale, foto martese, luftëtarë të lirisë, autoportrete, momente festash fetare dhe civile, peizazhe urbane dhe rurale, foto historike të Luftës së Parë dhe të Dytë Botnore, ambjente qytetare etj. Disa prej fotove kanë ardhë deri më sot tue u përshkue në rrugëtime aventureske, si për shembull 1300 negativat në xham të Dhimitër Vangjelit të cilat kanë fjetë për gjashtë dekada në nji arkë municionesh në nji shtëpi në Kolonjë.

Çdo foto pasqyron jo vetëm objektin e fiksuem por edhe pjesën e shpirtit të artistit që asht derdhë në të. Çasti i shkrepjes, drita, shprehia e subjektit, kompozimi, shtresëzimet e planeve, detajet e theksueme me dashje dhe ato që flasin vetvetijshëm na përcjellin emocione të veçanta.

Skenat e jetës korçare të Kristaq Sotirit, portretet e Vani Burdës, talenti unik i Perikli Kaçaunit - që shkëlqen në 9 fotot e ekspozueme, syni delikat i Dhimitër Vangjelit, na bajnë me mendue se fatmirsisht në Shqipni nuk ka ekzistue vetëm dinastia e Marubëve por ka pasë nji "konstelacion të fotografëve të traditës", siç i quen vetë kujdesuesi i ekspozitës. Marrim si shembull foton "Ceremonia mortore" të Dhimitër Vangjelit, i cili ka mbërrijtë me përçue me shkrim kaligrafik takmin e jetës me vdekjen. Fotoja asht pa datë dhe vendshkrepje, por me shumë gjasa e bame në nji fshat të Kolonjës në dhjetëvjeçarin e dytë të shekullit XX. I vdekuni, nji burrë i ri rreth të tridhjetave asht i shtrimë në arkëmort dhe simbas traditësh së lashtë ka nji monedhë mbi buzë, afër tij e bija e mitun me duert e lidhuna mbi bark prezantohet tragjikisht për herë të parë me vdekjen në nji mpimje totale dhe duket sikur po eksploron e shtangun ndryshimin radikal që vizitorja e paftueme i ka shkaktue tashma jetës së saj. Ankthi i pafajnisë së asaj vajze, mosnjohja e efektit shkretues të vdekjes, janë shumë ma tragjike se nji oqean me lot dhe me britma. Në sfond nji plak me ballin e rrudhun sheh me ma shumë interesë dhe kureshtje objektivin sesa vdekjen që i asht ndalë krejt pranë, tue qenë se ai prezantimin me vdekjen e ka ba me kohë dhe pret vetëm rradhën e tij.

Disa prej fotove kanë thjesht vlera dokumentare, disa të tjera janë artistiko-dokumentare, dikund drita ka fiksue imazhin, dikund tjetër drita ka shkrue artistikisht realitetin e kjo gja na ban me udhtue në kohë tue përjetue subjektivitetin krijues të "vendit" që paraqet fotografia. Ato "vende" sot janë transformue, gjurmët kanë humbë pse fytyrat, veshjet, rrugët, ceremonitë janë kthye në "jo-vende" (*non lieux*) - për me përdorë nji topos të antropologut Marc Augé, të cilat nuk na lejojnë ma me dekodifikue gjurmë identitare të forta. Kjo asht edhe arsyeja pse në format e sotme të këtij arti e kemi shumë ma të vështirë me zbulue e me u thellue, pse homogjeniteti – tue nisë nga teknikat, aparatet, subjektet – mbulon çdo dallueshmëni. Fati i fotografisë asht i lidhun ngusht me përmasat globale në të cilat konsumohet ekzistenca jonë sot, ne vetë jemi ma pak autentikë dhe drita që na përshkron në mënyrë digjitale e ka të vështirë, në mos të pamundun, me zbulue diçka esenciale tek ne. Miliona shkrepjet e sotme janë miliona byte, por kurrsesi miliona vepra arti, tue qenë se kur bahet fjalë për artin sasia dhe saktësia nuk prodhojnë kurrë cilësi. Pasunia e kompleksitetit asht shumë ma e randësishme sesa qartësia dhe univociteti – do të kishte thanë Robert Venturi. Acidi i fotografisë së dikurshme duket se mbërrinte me gdhendë ma thellë dhe me mshehë mrekullisht nën palat e dritëhijeve nji semiotikë jokonvencionale, gja që sot precizioni i algoritmeve kompjuterike injoron vetvetijshëm.

Asht kënaqësi me kundrue në Shkodër artistat e arealit korçar. Nga Shkodra në Korçë na lidhë nji "fil rouge" që na ban me dallue cimat që kanë ankorue artin e fotografisë shqiptare tek tradita e artit botnorë.

E gjithë kjo asht e mundun falë zellit të nji kolektivi dinamik të Muzeumit Marubi i cili drejtohet me shumë pasion prej disa vitesh prej Luçjan Bedenit.

Shpresojmë ndërkaq që nji të nesërme me mbërrijtë me pa të ekspozuem në Shkodër koleksionin në xham të fotove të Kolë Idromenos, i cili u pat dërgue para gadi 50 vjetësh prej etnologut Rrok Zojzi me u ruejt në Tiranë, por që sot s'ka ma asnji arsye për me ndejtë larg shtëpisë së vet, ku tashma ekzistojnë kushtet e ruejtjes me kritere bashkëkohore si edhe ato të digjitalizimit dhe të ekspozimit.

Kemi nevojë me zbulue traditën e fotografisë shqiptare, pse ato negativa në xham janë dokumente thellësisht pozitive të shpirtit dhe qytetnimit tonë europian.

Në numrin e saj të fundit, gazeta e njohur letrare EaN (En attendant Nadeau) boton një analizë të studiuesit Jean-Paul Champseix, autor i librit të njohur "Bulevardi Stalin 47", mbi botimin në Francë të romanit të Ylljet Aliçkës "Valsi i lumturisë"

"VALSI I LUMTURISË" I ALIÇKAJT, NJË ROMAN SHKRUAR ME MENÇURI DHE HUMOR TË ZI

nga Jean-Paul Champseix

Nga Shqipëria vjen një vepër e re e Ylljet Aliçkës, me një titull në ekstremet e ironisë: *Valsi i lumturisë*. Autori është frymëzuar nga një histori e vërtetë ndodhur në Tiranën e tij në vitin 1985. Një familje, katër motra e dy vëllezër, ia dalin t'ia hedhin rojës së ambasadës italiane për të kërkuar azil politik.

Të gjashtë shpresuan naivisht se brenda disa ditësh çështja e tyre do të rregullohej dhe do ta gjenin veten në Romë, pa llogaritur ashpërsinë e regjimit të hekurt stalinian të Enver Hoxhës, i cili i konsideronte qytetarët e tij krejtësisht si pronë e shtetit.

Për pasojë, atyre iu desh të jetonin pesë vjet në bodrumet e ambasadës, rrethuar tashmë nga policë e ushtarë. Personeli italian i ambasadës, përfshi edhe ambasadorin, pësuan poshtërime dhe fyerje pafund nga autoritetet shqiptare.

Natyrisht, ata i druheshin ndonjë të çare në kështjellën e rrethuar që kishte farkëtuar vizioni i tyre maniak. Nuk dyshonin aspak se çfarë i priste...

Ylljet Aliçka është autori i "Parullave me gurë" që evokonte në një formë tragjikomike detyrën e shkrimit të parullave me gurë në faqet e kodrave për lavdinë e regjimit të Hoxhës.

Një film u realizua mbi skenarin e autorit të të njëjtit libër nga regjisori Gjergj Xhuvani, i cili mori edhe çmim në festivalin e Kanës.



Aliçka ndjek hap pas hapi kalvarin e familjes Popa, që në roman i quan Tota, – duke i sjellë lexuesit tiparet e një prej diktaturave më të pashpirta të planetit.

Autori përkon hyrjen e familjes në ambasadë me vdekjen e diktatorit.

Situatë e rëndë: populli duhet të derdhë lot, ndërsa sigurimi ka për detyrë të vlerësojë seriozitetin e qarjeve. Drejtuesit e administratës dhe të ndërmarrjeve rivalizojnë me nivelin e dhembjes, gjë që nuk është fort e lehtë. Ndërsa gratë, atyre u vjen në ndihmë rënia e të fikëtit. Njerëzit e pasinqertë ndëshkohen, duke mos u lejuar të marrin pjesë në funeralin e Udhëheqësit.

Bie fjala, njëri prej vëllezërve të familjes Tota, Vangjeli, meritoi etiketimin e hidhur: "Lot hipokritë dhe mungesë e theksuar pasioni gjatë shprehjes së dhembjes."

Familja Tota është "e deklasuar", biografia e tyre ka një hije të rëndë: babai i tyre, që kishte studiuar në Itali për farmaci, gjatë luftës u kishte shitur barna ushtarëve të plagosur italianë, fakt ky për të cilin vdiq në burg nën regjimin e Hoxhës.

Ky është edhe shkaku që fëmijët e farmacistit mbetën të pamartuar, sepse çdokush me biografi normale që do të guxonte të martohej me ta, do të thoshte që ishin kundër regjimit. Bie fjala, rasti i një inxhinieri i cili u josh nga bukuria e Irena Totës, të cilin e degdisën në një hidrocentral malor për shkak të "zbutjes së luftës së klasave".

Është Simoni, vëllai i vogël, hamall, sepse nuk ishte autorizuar për të ndjekur studimet, ai që konsiderohej si "një agjent perëndimor i pazbuluar", i cili pati idenë që të kapërcejë me gjithë familjen pragun e ambasadës italiane. Veshur me rrobat e tyre më të mira, "që mbanin erë naftalinë", tek kapërcejnë gardhin e ambasadës, ata flasin italisht për të krijuar përshtypjen se janë italianë.

Roja shqiptare, i ndërgjegjshëm se është mashtruar, përpiqet të hyjë në oborrin e ambasadës me pistoletë në dorë e më pas për t'ia drejtuar armën vetes, sepse ai e dinte fatin që e priste.

Ambasada italiane rrethohet nga 600 policë dhe një sistem përgjimi instalohet aty pranë.

Por, meqenëse gjethet e pemëve pengojnë valët e përgjimit, atëherë u hidhet helm gjithë pemëve përreth ambasadës.

Altoparlantët përhapin muzikë funebre, për t'u ndërprerë nga zëri i rëndë i spikerit, i cili deklaron se Totat janë agjentë të huaj të implikuar në veprimtari kriminale kundër shtetit shqiptar. Qeveria do të donte të sulmonte ambasadën italiane, por ndofta një fakt banal i frenoi: italianët ua kanë marrë ndërtesën me qira Shteteve të Bashkuara, të cilat e zotëronin këtë terren që para luftës.

Përpara ambasadës organizohen "spontanisht" manifestime kërcënuese, duke u kujtuar pipinove të kaluarën e tyre fashiste, të cilët partizanët shqiptarë i kishin flakur në det.

Veteranët këmbëngulin që të mos i lënë të gjallë, por zhgënjehen kur marrin vesh se kardinal Mindszenty ka qëndruar 15 vjet brenda ambasadës amerikane në Budapest, duke u kujtuar veteranëve reumatizmat e gjymtyrëve të tyre. Në Shqipëri, në rast të një krimi, faji bëhej kolektiv. Pra, krejt familja duhej të mbante përgjegjësi për fajin e dikujt.

Pushteti kërkon arrestimin e kushërinjve, qoftë edhe të largët, të familjes Tota. Duke qenë se familja Tota nuk la të afërm, arrestohet një familje me mbiemër të përafërt: Popa! Ata jetojnë në qytetin N., aluzion ky me një qytet anonim që hasim shpesh në veprën e Ismail Kadaresë.

Ylljet Aliçka na zbërthen deformimet e një regjimi ku çnjerëzorja rivalizon me groteskun.

Gjashtë Totat që besuan se shpëtuan, kuptuan se me gjithë përpjekjet e ambasadorit italian, pasuesi i zbehtë i Hoxhës, Ramiz Alia, nuk u tërhoq, pa guxuar të ndryshojë gjë.

Vitet kalojnë dhe Totat e stërlodhur detyrohen të marrin antidepresivë.

Një herë provojnë të bëjnë grevë urie. Fillesa e një idili mes Ileanës dhe një polici të pashëm italian nuk tolerohet nga i vëllai, Simoni, i cili qorton të motrën se "nuk jemi futur këtu për të bërë gilivili me pipinot". Totat u liruan falë një ngjarjeje historike: në shkurt të vitit 1991 rrëzohet përdhe statuja e Enver Hoxhës, qeveria detyrohet të bëjë koncesione.

Të ndodhur në territor italian, Totat refuzojnë të plotësojnë formularët shqiptarë. Çështja zgjidhet nga Tirana, falë premtimit të një ndihme ekonomike si dhe të vizitës historike të Pérez de Cuellar-it, sekretar i përgjithshëm i OKB-së që garanton mbrojtjen e familjes.

Ndërkohë, ambasadori italian ka vdekur i rraskapitur vetëm një muaj pasi ka dorëzuar funksionin. Zëvendësi i tij, që i gëzohet largimit të Totave, është shumë larg asaj që e pret: nis pushtimi i ambasadave perëndimore nga mijërat e shqiptarëve. Madje, edhe skulptori i kokës së statujës së çmontuar të Enver Hoxhës kërkon azil, sepse nuk pranon kërkesën e pushtetit për të bërë një statujë të re dhe parapëlqen të lërë vendin (fakt autentik).

Totat, që u shndërruan në pionierët e ekzilit, shpresojnë të priten si heronj, por përfundojnë në një kamp refugjatësh, në shoqërinë e emigrantëve afrikanë, për t'u sistemuar më pas në një ndërtesë komunale në periferi të Romës, ku edhe sulmohen nga fqinjët.

Ëndrra kapitaliste u shkërmoq shumë shpejt dhe tragjedia vazhdon: një grindje bëhet fatale për Simonin; Irena shtrohet në psikiatri, pasi fyhet nga dikush që i propozon martesë; Ileana, e kthyer në Shqipëri, përpiqet më kot të rimarrë shtëpinë familjare të zënë tashmë nga një djalë i ri që pretendon se e ka blerë atë.

Autoritetet lokale që besojnë se familja Tota jeton në mrekullitë e Kaprit a në gondolat e Vencias, nuk e kuptojnë dot se pse ajo kërkon të rimarrë këtë karakatinë dhe t'u bëjë dëm shqiptarëve të varfër që kanë mbetur në vend... Ramiz Alia, i cili kishte bërë be se askush nuk mund të braktiste vendin, u detyrua të lejonte largimin e të gjithë shqiptarëve futur nëpër ambasada. Ata mbërrijnë në Itali dhe dëshpërojnë një funksionar italian, i cili nuk pranon më të dëgjojë nga refugjatët, se ata të gjithë kanë marrë pjesë në rrëzimin e statujës së Enver Hoxhës.

Nën një ironi të distancuar, me një ndjesi mbytëse, ngjarje të dhembshme përshkallëzohen pa vështirësi në roman, parë nga një logjikë vërtet tragjike.

Ismail Kadareja në parathënien e librit, ndër të tjera, thotë se "terrori bëhet lidhja e vetme e mundshme sociale dhe e papërfytyrueshme. Çmenduria bëhet kështu sjellja më banale".

Në realitet, çështja Popa përfundon me dy vetëvrasje, dy shtrime në psikiatri, ndërsa e mbijetuara e vetme jeton sot duke mbledhur kanoçe bosh në kazanët e plehrave ku grindet me mbledhës më të fortë se ajo. Ylljet Aliçka ia ka dalë të shkruajë pa pathos, përderisa vetë realiteti e kapërcen fiksionin. Cilësisë së padiskutueshme letrare të romanit i shtohen dhe vlerat historike e morale. Kjo është aq e vërtetë, përderisa një numër fatesh janë humbur në anonimat dhe harresë nga një regjim që nuk i ka njohur kurrë krimet dhe që autori di t'i përshkruajë me mençuri dhe humor të zi.

"Aliçka ndjek hap pas hapi kalvarin e familjes Popa, që në roman i quan Tota, – duke i sjellë lexuesit tiparet e një prej diktaturave më të pashpirta të planetit.

LIBRI I RI

Një botim i ri nga Ombra GVG

"APARTAMENTI NË KATIN E KATËRT" I CHARLES CASHA NË SHQIP

nga Anisa Trifoni

Me një galeri komplekse personazhesh dhe botë të pasur psikologjike, shkrimtari Charles Casha jep përmes veprës së tij një thirrje për reflektim shoqëror. I lindur në Marsa në vitin 1943, Charles u arsimua në Lyceum dhe pas përfundimit të një kursi 2-vjeçar në kolegjin "St. Michael", u diplomua si mësues në vitin 1965. Më 1982 Universiteti i Maltës i dha një certifikatë vlerësimi mbi *Teknikat bazë të punës në bibliotekë* dhe tre vjet më vonë (1985) një diplomë në *Studimin e gjuhës malteze*. Por kontributi i tij ishte edhe më i gjerë. Për shumë vjet ai ishte anëtar aktiv në organizata të ndryshme rinore të tilla, si: Këshilli Rinor Konsultativ i Maltës dhe Rrethi Rinor Shëtitës. Në të njëjtën kohë, e gjejmë të përfshirë në projekte të ndryshme pune vullnetare në Kalabri dhe Maltë, si pjesë e Trupës së Shërbimit Vullnetar (Maltë). Po ashtu, ai dha kontributin e tij edhe në organizata e lëvizje letrare, siç ishte Moviment Qawmien Letterarju (Lëvizja për promovimin e letërsisë).

Përgjatë viteve Casha është vlerësuar me një sërë çmimesh. Në vitin 2007 këshilli lokal i Marsës i akordoi çmimin Gieh *il-Marsa* dhe në vitin 2013 këshilli lokal i Zabbar-it e nderoi me çmimin Hieh Haż-Żabbar. Po ashtu në vitin 2012 u vlerësua me *Midalja Ghall-Qadi tar-Repubblika* (*Medalje për shërbimin ndaj Republikës*) me motivacionin shërbim i dalluar ndaj Maltës si shkrimtar. Aktualisht ai është anëtar i L-Akkademja tal-Malti (Akademisë Malteze) dhe për nëntë vjet ka dhënë një kontribut të çmuar edhe në Kunsill Nazzjonali tal-Ktieb (Këshillin Kombëtar të Librit). Libri i tij *Il-Klabb - L-Ghaxar Anniversarju*, kryesisht për adoleshentë, fitoi çmimin e letërsisë për fëmijë në vitin 1998. Tre vjet më vonë (2001) iu dha i njëjti çmim, këtë radhë për librin *Gummienu*.

Por autori është jo pak i njohur edhe në lëmin ndërkombëtar. Në tetor 2012 përfaqësoi Maltën në Festivalin e Letërsisë Tanpinar në Stamboll dhe tregimi i tij *Il-Fjura tat-Tlitt Ilëien* (*Lulja trengjyrëshe*) u botua në anglisht dhe turqisht në dy antologjitë Şehir *Ve Korku* (*Qyteti dhe frika*). Po ashtu, një përzgjedhje nga romani *L-Appartament fir-Raba' Sular* (*Apartamenti në katin e katërt*) u botua në anglisht në antologjinë *Përtej detit të mëndafsh* në vitin 2016.

Një version anglisht i librit është botuar nga shtëpia botuese "Midsea Books". Vlen të përmendet edhe fakti që Casha ishte autori i parë maltez që ka kontribuar në Bibliotekën Digjitale Ndërkombëtare për Fëmijë me librin *Pandolino/ Galatea*.

Rrugëtimi i tij drejt suksesit nisi në vitin 1960, kur ishte ende student. Ai njihet kryesisht si autor i librave për fëmijë, por jo vetëm. Casha ka shkruar edhe tregime e romane për të rritur, ndër të cilët është edhe *Apartamenti në katin e katërt*. Ky roman, i cili konsiderohet si një nga librat e tij më të mirë, është vlerësuar me çmimin e dytë në Konkursin Kombëtar të Letërsisë në vitin 2005. Aty Casha eksploron personazhe dhe situata të marra nga jeta e përditshme, duke i përshkruar me ngjyra kaq realiste, saqë lexuesi bëhet kurioz të mësojë më shumë. Tema kryesore që përshkon gjithë romanin lidhet me idenë që koha dhe hapësira janë ato që mbrujnë dhe formësojnë fatin e personazheve. Koncepti që të gjithë jemi viktima të njëri-tjetrit spikat dukshëm në roman. Historia e secilit prej personazheve është mjaft e goditur dhe e përshkruar me shumë dashuri, sikur të ishin pjesë e një tabloje ku secili përballet me vështirësitë e jetës në mënyra të ndryshme, aq sa edhe vetë lexuesi arrin ta gjejë veten aty. Një tjetër temë është edhe ajo e dashurisë për nënën, e cila jepet me një freski që gati-gati të prek. Epilogu i qëndron besnik rrjedhës së ngjarjeve që, në thelb, përshkruajnë një dramë të pastër njerëzore.

Samueli, personazhi kryesor, duket se ka dështuar të integrohet e të bëhet pjesë e shoqërisë. Portreti i tij na serviret në mënyrë mjaft bindëse. Diçka e lënë përgjysmë vite më parë është makthi me të cilin duhet të përballet tani. I gjendur vetëm dhe pa një sup ku mund të mbështetet, i mbetet të çajë përpara krejt i vetëm dhe të mundohet të jetojë në botën reale dhe jo në botën imagjinare të njerëzve që i thërret në emër. Herë pas here vërehen pikëtakime me diçka që shkon përtej jetës, pikëpyetje mbi atë që ndodhet përtej varrit ku vendosen lule çdo muaj. E vërteta mund të jetë e dhimbshme dhe e vështirë për t'u pranuar, por rrugëtimi drejt saj është mënyra e vetme për të mësuar më shumë. Në fund shikojmë që Samueli zgjedh të jetojë në apartamentin e katit të katërt si një formë shpagimi. Sidoqoftë, i mbetet lexuesit të thellohet mbi arsyet që e shtyjnë të marrë këtë vendim, duke e shndërruar kësisoj këtë roman në një thriller të vërtetë psikologjik që të tërheq deri në fund.

MIRA MEKSI
LA GRINGA

tregim

Askush nuk e pa pasditen e vakët të nëntorit, kur me një fuoristradë të marrë me qera, la udhën turistike që të shpinte në rrënoret arkeologjike të Chichén Itzá-s dhe u fut në xhunglën e Yucatán -it.

Askush nuk e pa kur eci edhe rreth një orë me makinë përmes një bimësie të harlisur tropikale dhe një morie iguanash gjigante që i prisnin rrugën heraherë, dhe e braktisi makinën në një lirishtë të vogël. Askush nuk e pa kur paskëtaj, zuri ta çante udhën e xhunglës me një satër të shkurtër, duke bërë përpara ngadalë, duke përgjuar zhurmat dhe duke u ndalur hera-herë për të verifikuar drejtimin me anë të një busulle ushtarake. Trualli kish filluar të kthehej në ujesë, dhe baltovinat e shenjta shpejt i zunë vendin. Ende kish dritë në qiell, por vetulla e hënës në rritje kish nisur të përvijohej në të. Flatrimi i fuqishëm i një trumbe shpendësh të panjohur i tregoi drejtimin e rrënojave të tempullit të lashtë, të cilin busulla po vononte t'ia rrëfente. E njihte mirë *tzolki*-n, kalendarin ritual të mayave, ashtu siç njihte edhe *cholti-n*, gjuhën e tyre klasike. Mayat tani jetonin në ciklin e V të diellit.

Zjarre të lashtë e kishin kafshuar pa reshtur për qindra e qindra vjet tempullin e Kukulkán - it,† por platforma e tij dukej e paprekur prej tyre, apo si e përtërirë pas djegies. Në mes të saj, brenda një qerthulli të plotësuar, ndodhej vatra e gurtë që mbante zjarrin e gjallë. Ishte qerthulli i shenjtë planetar nga ku dilnin udhët e yjeve të qiellit. Muzgu i ceiba-s‡ mijëravjeçare, krahët e stërmëdha të së cilës kishin marrë nën sqetull rrënojat e tempullit, po mbulonte ngadalë tokën. Platformën tempullore e popullonin rrjedhësit e mayave të lashtë, njerëzit e kasolleve me liane dhe guano që kishin shpirt, që ishin pa dritare dhe zjarrin e ndezur përmbi tre gurë e mbanin mu në mes të tyre. Ishin kasolle të shpërndara fshatrave të nxehtë dhe të lagësht brenda xhunglës së Yucatán –it. Sonte ajo ishte një prej tyre.

E la veten të rrëmbehej nga festa rituale përballë rrënojave të zbukuruara të tempullit, e zhurmshme dhe me plot ngjyra, të cilat, flakët e zjarrit të vatrës së gurtë së bashku me ato të pishtarëve dhe qirinjve të shumtë i feksnin marramendshëm. Tymi i temjanit dhe copa-lit kishin mbushur hapësirën e tempullit. Kur njëri nga priftërinjtë i dha në dorë pijen ceremoniale tempullore dhe ajo piu gllënjkën e parë, ndjeu një si tërmetth brenda rropullive të saj. Ishte një ndjesi e paprovuar më parë, e cila e la pa frymë nga befasia dhe mëpastaj nga gëzimi. U mbështet pas nofullave të fuqishme të kokës së gjarprit prej guri që i rrinte roje shkallareve të paprekura të tempullit, dhe nga buzët i doli një pëshpërimë: "Biri im!". Kështu foli ajo dhe vuri dorën mbi bark për ta qetësuar.

U ruajt dhe nuk hëngri kërpudha haluçinogjene rituale, të cilat mund ta dëmtonin krijesën e saj; pija tempullore do t' i mjaftonte që të arrinte harmoninë kozmogjenike dhe, kësisoj, të mund të dallonte brenda mjegullinave të Krijimit zemrën e të birit që mbante në bark.

*

Vallet e burrave dhe këngët e korit të grave që kishin shungulluar rrënojat e tempullit kishin pushuar. Po ashtu edhe ritet e "dëlirjes". Perëndi̇të e majave duheshin ushqyer që të mund t'iu përkushtoheshin njerëzve. Nisën sakrifikimet dhe vetsakrifikimet. Në *el Cenote Sagrado,* pusi i shenjtë i tempullit, u hodhën kafshë të grira nga shigjetat dhe monedha, si blata për perëndinë Kukulkán. Njerëzit shpuan mishin e tyre me maja kockash dhe gjemba të egër, mblodhën gjak në gjethe dhe kërcej bimësh, dhe ia falën perëndisë. Paskëtaj, nxorën eshtrat e të parëve të tyre që i kishin ruajtur me përkushtim tradite, si edhe ato më rejat e të afërme dhe i pastruan me kujdes. Më pastaj, bojë e kuqe u derdh bujarisht përmbi eshtrat e të ikurve nga kjo botë...

Koha e vdekjes kishte mbaruar. Po niste një kohë tjetër. Koha e rimishërimit.

Ajo vazhdonte të pinte me gllënjka të vogla pijen tempullore, ndërsa murmurimat e formulave magjike të "Popol Vuh" librit të shenjtë të mayave të lashtë, merrnin qiellin. U ndje e papeshë; marramendja e fillimit iu kthye në një qartësi të madhe ndjesore. Pak e nga pak, koha e re nisi të mbushte hapësirën dhe kaosi kozmik që e përfshiu më parë dhe ku ajo u ndie papritur e tmerruar nga braktisja dhe vetmia, nisi të davaritej për t'ia lënë vendin harmonisë. Me sy të kthjellët ajo shqoi zinxhirin e planeteve me shtatë orbita, ku në çdo orbitë kishte shtatë rrathë zhvillimi, të cilët formonin dyzetë e nëntë stacione të ekzistencës. Ishin përvojat e ndërgjegjes së të ikurve për dyzetë e nëntë ditë nëpër shtatë botët...

Tani e ndiente veten të sigurt, e rrethuar nga një ngrohtësi miqësore dhe shpresëdhënëse. Tani mund të rrugëtonte e qetë drejt zemrës së të birit. Nga vdekja e të tjerëve u derdhën përmbi të vezullime dritash dhe horizonte të shkëlqyera; në vesh i erdhi tingulli i natyrshëm i së vërtetës; sytë i panë atomet e farës yjesore, atomet e farës së mendjes dhe atomet e zemrës. Më në fund, mjegullimave të kaltra të Krijimit dalloi atë që dëshëronte të shihte: zemrën e të birit në trupin e saj. Ishte ashtu siç e kishte imagjinuar kur e ndërtonte verbazi me lëndën e shpirtit brenda rrjetit të ngatërruar të gjakut për rreth pesëdhjetë ditë e netë: e kuqe zjarr dhe regëtitëse, e fuqishme dhe drithëruese. Po kundronte veprën e saj nën vullnetin e të Madhit, me dashuri, me dhembshuri dhe krenari, kur fryma e pavdekshme e kozmosit kaloi kufirin e buzëve të saj dhe i kaploi shpirtin§...

Drita e agimit kish mbuluar tokën, kur ajo mori udhën e kthimit.

*

Një gjumë i thellë dhe përtëritës e mbajti të mbërthyer në shtrat për tri ditë dhe tri netë me radhë. Mëngjesin e ditës së katërt, si e rilindur dhe plot me një energji të pazakontë, pasi hëngri *mole* dhe piu një kupë të madhe me lëng ananasi dhe mjaltë bletësh, u ul të punonte për studimin e saj mbi palingenezinë¶ maya. Do të punonte shumë që të rifitonte kohën e humbur në gjumë. Por pas rreth një ore që u përpoq më kot të gjente fillin e ndërprerë të

* Gringo/gringa – kështu i thërrasin të huajt në Amerikën Latine

† Kukulkán – perëndia më e rëndësishme e Maya-ve të lashtë i ngjashëm me Gjarpërin me pendë. Lidhet me ajrin, ujin dhe rimishërimin.

‡ Ceiba – pemë gjigante e konsideruar si "pemë e shënjtë" nga Maya-t

§ Sipas besimit të Maya-ve të lashtë, rimishërimi ndodhte me anë të frymës së pavdekshme që kalonte buzët e një gruaje shtatzënë.

¶ Palingenezia – është termi i përdorur nga filozofët stoikë për të treguar rindërtimin e botës pas shkatërrimit nga Zjarri. Emri në greqisht do të thotë " rilindje", "rigjenerim".

studimit, duke i parë dhe stërparë fishat, kartelat, shënimet dhe gjer fotot e bëra ditë pas dite, hoqi dorë prej tij dhe mendoi të hidhte së pari në kompjuter gjithë ç'kish parë dhe ndjerë gjatë festës rituale mbi platformën përballë rrënojave të tempullit të Kukulkán – it, në zemër të xhunglës së Yucatán-it.

Hapi *file*-in "shënime përgatitore" por, ndonëse u zhyt në kujtimin e katër ditëve më parë dhe me sytë e mendjes pa dhe ndjeu mëpastaj me ndjesitë e kujtesës ceremoninë tempullore, asnjë fjalë nuk mundi të shkruante për të. Gjithçka vinte dhe ngatërrohej tamam në çastin kur duhej të formonte fjalët dhe fjalitë: pamjet shndërroheshin në mjegullina të shformëta, dhe ndjesitë në turbullime pa emër që i rrëshqisnin dejve...

Humbi shumë kohë përpara kompjuterit duke mos bërë dot asgjë, dhe ndërsa energjia i rritej brenda trupit dhe mendjes, e kaploi dëshpërimi i bllokimit përpara faqes së bardhë. E braktisi shkrimin. U përpoq të mësohej me gjendjen e re në të cilën ndodhej, me energjinë e madhe dhe të panjohur brenda vetes dhe me pamundësinë për ta shndërruar në punën e saj studimore. E ndiente që nuk ishte energjia e vet, nuk ishte as ajo që krijohej nga zemra e të birit, e cila përtërinte gjakun e zemrës së saj; ishte diçka e fuqishme, e huaj dhe e mistershme që po rrekej të bëhej njësh me të.

Kaluan ditë, përpara se ajo të ulej sërish në kompjuter nga një impuls i papritur dhe i beftë. Ortekë mendimesh dhe lumenj fjalësh u derdhën atëherë nga gishtat e saj. Dukej sikur një forcë e pazakontë kishte shpërthyer digat e një rrëfimi të rrjedhshëm dhe të fuqishëm që flinte brenda saj. Ishte një rrëfim që po i rrufiste edhe grimcën më të vogël të kohës. Kaloi ditë dhe netë duke shkruar vrullshëm, pa e ndjerë lodhjen, me një lloj mbushje shpirtërore dhe lartësimi që nuk i kish ndjerë kurrë më parë. Jeta e gruas tani po rridhte e tëra në hullinë e një shkrimësie, e cila nuk kishte asnjë lidhje me studimin e saj. U bë e ndërgjegjshme për këtë vetëm pasi pasi kishte shkruar dhjetëra e dhjetëra faqe në fill të frymës.

Një muzg të qetë dhe të vakët fillimdhjetori ajo e ndali punën, apo puna vetë i ndali gishtat e saj mbi tastierën e kompjuterit; u vu të lexonte atë ç'ka kishte shkruar. Që në grërmat e para pati ndjesinë se nuk po lexonte shkrimin e saj, por të tjetërkujt: ishte një prozë drithëruese dhe magjepsëse, nga lloji i atyre që të ndryshojnë jetën pas leximit. I shkruar në një spanjishte të shkëlqyer, të përkorë, të drejtpërdrejtë dhe përshkruese, rrëfimi epik ishte qerthullor, -- vetmia, dëshpërimi, idengulitjet dhe absurdi përsëriteshin pa fund. Porse lënda e prozës mjeshtërore të fantazisë dhe magjisë ishte e njohur dhe e afërt për të. Aty shtrihej fati i një vendi të vogël në askundin e botës, i cili gjallonte në një mbyllje dhe izolim të skajshëm prej botës së madhe, nën peshën e një diktature të frikshme të panjohur më parë prej njeriut. Me zemrën që i rrihte fort prej emocionesh të mistershme, ajo lexoi për fatin e disa brezave njerëzorë pa Zot, me mendje të mpirë dhe pa identitet, të dënuar brenda një moskomunikimi të frikshëm dhe një hipokrizie ferri, ku burri spiunonte gruan dhe ku motra fuste të vëllain në burg për mospërputhje ideologjike, brenda një marrëdhënie të përbindshme të familjes me shtetin; ku gjithkush jetonte në frikë dhe në terror, që nga njerëzit-mekanizma të diktaturës dhe gjer te njeriu i fundit që jetonte brenda burgut të vogël apo brenda atij të madhit, që ishte i tërë ai vendth. Ishte fati i njeriut brenda një braktisjeje dhe vetmie monumentale, ku e vetmja shpresë për çlirim dhe dritë në fund të tunelit, ishte profecia e një cigani të rrallë, e cila rrëfente se liria do të vinte nga shembja e një muri të madh ndarës absurd...

Dorëshkrimi që dorëzoi një ditë më vonë në shtëpinë më të madhe botuese të Ciudad de Mexico, "Editorial Era", ishte rreth 100 faqe A4, gërmat Times New Roman 12.

*

Antropologia e re, të cilën të gjithë e thërrisnin *la gringa*, siç i quanin rëndom të huajt, sipas zakonit vendas, vinte nga një vend i vogël i Ballkanit, mbante një emër të lashtë Thana, dhe kishte rreth dy muaj që jetonte në gadishullin Yucatán, në Meksikën juglindore. Vepra e saj "Kozmologjia e mayave" e botuar së pari në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ajo kishte kryer studimet e larta, dhe e përkthyer më pas në shumë gjuhë, e kish bërë një autoritet botëror të fushës.

Këshilli i botimit të shtëpisë botuese "Era" e shqyrtoi gjatë dorëshkrimin e mrekullueshëm të antropologes. U thirrën edhe kritikë të njohur letrarë dhe specialistë e studiues të kolumbianit të madh. Përfundimi ishte i prerë, i qartë, unanim, tronditës dhe shpresëdhënës për tërë njerëzimin: dorëshkrimi i antropologes së re ballkanase ishte, në të vërtet, pjesa e rrëfimit që mungonte në romanin "100 vjet vetmi" të shkrimtarit të madh kolumbian Gabrial Garcia Marquez, i shuar dy vjet më parë, në 2014, në Ciudad de Mexico. Ishte rrëfimi për brezin e tetë të familjes Buendia, të cilën Marquez-i nuk e kishte shkruar dot në gjallje të tij, në kohën kur iu desh që, për mungesë fondesh, ta mbyllte romanin gjenial gjer në brezin e shtatë të familjes Buendia. Ishte, në të vërtet, pengu i tij letrar.



"LUTJET E MESNATËS" SË KIM MEHMETIT MES REALES DHE SURREALES

Nga Majlinda Nana Rama

Kim Mehmeti është një nga ata autorë i cili e ka krijuar staturën e një prej prozatorëve më në zë të letrave shqipe përmes kolanës së veprës së tij gati gjysmëshekullore. Duke u ndalur në librin e tij të fundit "Lutjet e mesnatës" (Botimet "Agora", 2019), natyrshëm lind pyetja: "Ç'janë lutjet e mesnatës dhe pse pikërisht në mesnatë?" Lutjet e mesnatës janë emblemë dhe identikit i njeriut të ditës-heroit-unit autorial, që i shqetësohet shpirti dhe indi i tij për botën e ndërtuar mbrapsht, atë të sotmen. Dhe mesnata shënon orën dhe kufirin zero, mes asaj që mbetet pas dhe të mëpastajshmes që do të vijë. Ja pse lutje në mesnatë. Për të mos qenë si një e djeshme e sekondëkaluar, atje ku është caku ndarës: dje-sot-nesër; e mirë-e keqe. Pse në mesnatë? Sepse shpirti i trazuar i shkrimtarit nuk gjen paqe; nuk anatemon të keqen, "i fal ngaqë nuk dinë ç'bëjnë", por vazhdon të mos gjejë prehje nëse e nesërmja do të ketë të njëjtën shëmbëlltyrë si e sotmja. Lutja është thelbi i humanes që na dikton qysh në titull Kim Mehmeti, madje lutja e mesnatës është kufiri i ndarjes nga një e djeshme e padëshirueshme, e thënë me eufemizëm. Dhe këtu është momenti që "të nxjerrë krye" lexuesi: sa dhe si ndihet i pak-gjithë-a tejpërfshirë në heroin dhe unin autorial. Kjo është sfida për lexuesin – jo e vështirë dhe që kërkon një çikëz përqendrim. Ngjarjet në tregimet e Kimit vërtiten rreth jetës së përditshme, me zhvillimet, të papriturat, urtësitë, shpirtin human e njerëzor, dalldisjen dhe heshtjen, të bukurën dhe të shëmtuarën, mes reales dhe ëndrrës, dëshirës dhe refuzimit.

Ato përsillen rreth dashurisë, urrejtjes, teprisë dhe së munguarës. Autori ka gjetur një shteg në veprën e vet, duke e përsosur çdo hapësirë narrative me përshkrime e mendime që lëvizin nëpër kohë e hapësirë. Imagjinata e tij nuk njeh *status quo*, ajo lëviz duke sjellë me vete kombinime ngjarjesh reale me ato nga më magjiket. Kimi bëhet mjeshtër i pleksjes së imtësive, grimcave, gjërave të vogla në përmbushje të ideve të mëdha. Pasi lexojmë nëpër margjina, ne shohim se si shpalos, pa sforco, një mori sjelljesh e ndjesish, që shpesh nuk vërehen ose vërehen veç nga syri survejues dhe i vëmendshëm. Brenda kësaj perspektive autori bën analizë të jetës shoqërore në përgjithësi. "Lutjet e mesnatës" vjen me personazhe nga jeta e përditshme.

Me veset e dëshirat e përhershme. Disa me paragjykime, disa të mbushur me pasion, të tjerët me ndjenja të veçanta që lidhen me botën materiale e shpirtërore. Në këtë përmbledhje i gjen pothuajse të gjitha tipat njerëzorë. Edhe pse në disa tregime personazhet rimerren si emra, ato vishen me petk tjetër. Filozofia që e shoqëron mendimin kreativ të Kimit vihet re tek flladit përherë, herë dukshëm e herë në mënyrë diskrete, personalitetin dhe karakterin e personazheve të tij. Kimi vendos në qendër ngjarje-personazh dhe rreth këtyre dy shtyllave nis të ravijëzojë një mori të tërë rrugësh, alternativa e vizione. Ato dalin natyrshëm, sepse rrjedhat e shkrimit tregimtar ecin ashtu, lirshëm e pa ngërç improvizues. Duke iu referuar subjekteve të paraqitura në secilin tregim (pa u ndalur këtu në tregime të veçanta), vëmë re se kemi të bëjmë me prozë tregimtare gati të një realizmi magjik, ku personazhet paraqesin problemet jetësore e shoqërore, që ndërtojnë e shkatërrojnë deri në zhbërje ndjenjën njerëzore dhe nga ana tjetër, aspiratën e përhershme për zbulimin e më të mirës së njeriut. Për ta detajuar, në tregimet e librit "Lutjet e mesnatës" shohim: tipare realiste, në paraqitjen e personazheve nga shtresa të ndryshme shoqërore; elemente realiste, që pasqyrojnë zhvillimet e ditës; vendi i zhvillimit të ngjarjeve është ai që autori e prek çdo ditë, e njeh, ka ecur në të dhe e mban tërë kohës me vete, nëpër hapa narrativë. Krahë për krahë me këtë bosht real autori sfidon me surrealen, në papërcaktimin e kohës dhe hapësirës, komunikimin e personazheve të gjalla e të vdekura, vendosjen pranë e pranë të historive të qenësishme dhe imagjinare. Në pikëpamje historike, proza e shkurtër e Kimit paraqet në detaje jetën e gjallë të shekullit që jeton, ndërsa sa i takon një pikëpamjeje tjetër, asaj shoqërore, Kimi sjell tjetërsimin, transformimin e thelbit të njeriut, kërkesat për njohjen ndaj vetes, mundimin për të mbërritur te kuptimi në tërësi i qenies dhe materies. Gjithë ky arsenal dhënie-marrjesh e zhvillimesh na çon në kurmin psikologjik të veprës, përkatësisht të tregimit të Kimit, ku gjejmë vlerën materiale e atë shpirtërore përballë njëra-tjetrës me njeriun në mes, në rastin e autorit me njeriun që, sidoqoftë, kërkon të përsoset përmes një lufte të heshtur.

Rrëfenjat e Kim Mehmetit përqasen me rrëfenjat e Mitrush Kutelit, ku shohim dendurisht rrëfime mbi ngjarje të treguara; magjizmin markezian në ndërtimin e subjektit dhe intrigës. Dhe për të hedhur edhe një ide tjetër: rimarrja dhe risjellja e personazheve në situata të ndryshme, në tregime të ndryshme, na përsjell "Komedinë njerëzore" të Balzakut, por bash me origjinalitet të Kim Mehmetit. Individualiteti autorial i tij vihet re edhe në strukturën e veçantë e boheme. Proza, përkatësisht, tregimi i Kim Mehmetit, ecën nëpër teknika origjinale, pa ndjekur forma narrative të mëhershme. Kjo i bën tregimet e këtij libri dinamike dhe rrezatuese në aureolën e letrave shqipe në kapërcyell të dy shekujve letërsi.



"Shkrimtari Kim Mehmeti ka gjetur një shteg në veprën e vet, duke e përsosur çdo hapësirë narrative me përshkrime e mendime që lëvizin nëpër kohë e hapësirë. Imagjinata e tij nuk njeh status quo, ajo lëviz duke sjellë me vete kombinime ngjarjesh reale me ato nga më magjiket.

Në edicionin e 21-të të Panairit të Librit në Prishtinë është promovuar publicistika dhe eseistika, me prozë autobiografike e dokumentare, si trilogji e jetës së Lazër Radit: Prizreni ("Mjegullnaja e nji kohe të largët), trilogjia e jetës - Shkodra ("Gjurmat t'nji ditari të djegun"), trilogjia e jetës - Roma ("Vorbulla t'jetës universitare"), "Një verë me Migjenin", "Shqipnia e viteve tridhjetë" (kujtimet dhe shënime), "Ministri i hekurt, Mirash Ivanaj".

LAZËR RADI ZBRET N'PRISHTINË!

nga Agron Gashi

Lazër Radi, nji kosovar n'rrethin kulturor ma t'mirë të brezit të viteve '30-të, nji model kulturor n'mesin e artikuluesve ma t'mdhaj dhe ma profesionistë t'shqiptarizmës, t'shkencës e t'letërsisë, t'eseistikës e t'publicistikës shqiptare, krah Branko Merxhanit, Vangjel Koçës, Tajar Zavalanit, tri figura t'publicistikës, t'historisë e t'koncepteve të neoshqiptarizmës për nji Shqipni të reformueme. T'najtën kohë krah sensibilitetit e majave letrare, si Koliqi e Migjeni, krah interpretimeve filozofike dhe edukimit arsimor të Arshi Pipës, mik e njohës i jetës dhe i veprës së Musine Kokalarit, për të cilët ka shkrue kujtime, portrete, po edhe shkrime kritike. Dhe jo vetëm kaq, për t'qenë her' në skaj, e hër' në qendër të tyre dhe të bashkëkohanikëve të tjerë, si: Karl Gurakuqi e Ismet Toto, Anton Logoreci e Stefan Shundi, Lazar Shantoja e Et'hem Haxhiademi etj. Pra, të gjithë i njihte prej afër dhe bashkëpunonte me ta, i kishte miq n'jetë e n'literaturë, n'arsimim e kulturë.



Lazër Radi, herë ish qendra, herë periferia e këtij mendimi kulturor e politik, ish meditanti që thuri himne për Prizrenin e tij dhe tonin, por edhe militanti që njohu mirë guximin dhe burrninë e Qemal Stafës.

Lazër Radi, nji kosovar i madh që u ba nyje e mendimit e kulturës në mes Veriut dhe Jugut, në mes të Kosovës dhe Shqipnisë, por ajme, të parën e pati n'zemër përjetësisht për t'dytën, e dyta u ba ngritja dhe 'rania' e tij.

Lazër Radi, nji ideolog të cilit i mungoi aq shumë

Kosova, Prizreni, së fundmi po i kthehet Itakës së tij me nji testament letrar e artistik, me shkrime publicistike e eseistike, me prozën autobiografike e dokumentare, si trilogjia e jetës - Prizreni ("Mjegullnaja e nji kohe të largët), trilogjia e jetës - Shkodra ("Gjurmat t'ni ditari të djegun"), Trilogjia e jetës - Roma (" Vorbulla t'jetës universitare"), "Një verë me Migjenin" (kujtimet dhe shënime), "Ministri i hekurt, Mirash Ivanaj", si dhe librin e përkthyer "Sekreti i Anglisë" i Leo Ferrero-s.

Po i kthehet Itakës së tij, Kosovës, djali i saj i harruem për nji jetë të tanë, studenti kosovar i Romës, atje ku studioi Budi e Bogdani, nji kosovar që ishte i admiruem dhe gjeti përkrahje të madhe nga Musine Kokalari. Radi ish i përqëndruem dhe i doktoruem në filozofinë e së drejtës, e prej andej tuj e njohun edhe t'drejtën romake, deri te filozofia politike shqiptare.

Rol dhe mision i dyfishtë ky, krijues dhe filozof, njashtu si bashkëkohanikët e tij, si Musineja, që bani në letërsi e në kulturën politike, në frymën socialdemokrate, ashtu siç bani mocaniku i tij, Arshi Pipa, me krijimtari, studime letrare e filozofike, deri te filozofia e moralit dhe e fesë, sipas Bergsonit.

Mbi të gjitha, Radi ish në të njajtën udhë të t'menduemi me Koliqin, andrroi dhe admiroi Kosovën, kontribuoi për arsimin kosovar. Natyrshëm, për me qenë vetja, Lazër Radi i Prizrenit, Lazër Radi i Shkodrës.

Lazër Radi, studenti e studiuesi nga Prizreni, që i takoi këtij rrethi mendimtarësh e që, po ashtu, si nji pjesë e tyne, në mos ma shumë, mësoi dhe pësoi nga diktatura. Mësoi se si duhet çá para me dije e kulturë; pësoi burgun, terrorin për nji jetë, si Musineja, Pipa; provoi heshtjen e madhe po si Koliqi, Shantoja, Toto, po edhe si Merxhani e Koça.

> **"Lazër Radi, nji kosovar i madh që u ba nyje e mendimit e kulturës në mes Veriut dhe Jugut, në mes të Kosovës dhe Shqipnisë...**

Lazër Radi, vuajtjet e tij i bani apologji, apologji për të tjerët, për Petro Markon, Jusuf Vrionin dhe Andrea Varfin, me t'cilët ndau qelinë, bukën dhe vuajtjen. Më t'parin shestonte dashuninë për rezistencën, solidaritetin, heroizmin në luftë, mendimet për brezin e humbun.

Me t'dytin për pjesën tjetër të letërsisë frankofone, për përkthimet, ndaj edhe përktheu fshehurazi vepra autorësh të ndryshëm, në mesin e tyne ato të poetit malazias, Jevrem Bërkoviq: "Stalini, Moxarti dhe Maria Judina", por edhe veprën e ushtarakut malazez, Mark Milanit: "Jeta dhe zakonet e shqiptarëve", e deri te vepra e Platonit. Lazër Radi, sot po i kthehet Kosovës, Prishtinës, Prizrenit, pas nji shekulli në kërkim të fëmijënisë së humbun. Jo rastësisht tha: "Kosova leu intelektualët që i duheshin, Shqipnia i shkatërroi ata që i kish."

Ky asht' kthimi i vonë, po i fuqishëm, i intelektualit-filozof, shkrimtarit, disidentit që kurrë nuk u thye.

Lazër Radin pak e njohëm n'jetë, por rinjohja po ndodh nëpërmjet literature. E, rinjohja pas dekës nëpërmjet literature, thonë se asht' pakti ma i fortë i autorit me lëçitësin e tij, të cilit Lazër Radi, i la vepra t'kullueta dhe artistikisht të realizueme, gjithë kohën tuj marrë parasysh kohën kur ai nisi me shkru e me botu.

Sot, gjysma e veprës së Lazër Radit, (gjysma tjetër në dorëshkrim), merr trajtën e nji testamenti, që hyn në dialog të gjithëhershëm me të tjerët, tuj mbetun shenjë jete, shenjë pasioni, shenjë përkushtimi e përvujtnie.

N'tanësi, vepra e Lazër Radit asht' shpirti i tij i gjallë i mbetun n'jetë, asht' zani i tij prej poeti e prozatori, eseisti e filozofi, përkthyesi e studiuesi, asht' zani i thellë i medituesit të madh.

Në fund, po citoj një fragment interviste, të dhanë më 1992: "Kosova, Prizreni është ëndrra ime më e madhe, dëshira ime më e flaktë. Zoti deri tani m'i ka plotësuar të gjitha dëshirat. Duket se do të ma realizojë ëndrrën time të madhe, të shoh edhe një herë Prizrenin tim. Ditën e kthimit në vendlindje e përfytyroj si kthimin e Uliksit në Itakë. Me një ndryshim, a pas shumë peripecish dhe aventurash udhtimore, në fund, pas njëzet vjetësh, mundi t'i hedhë çengelat në Itakë. Po, unë po m'u dha mundësia e bëj pas 62 e vjetësh, prandaj dhe malli dhe dëshira janë dyfish më të mëdha."

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, në bashkëpunim me Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Malit të Zi, zhvilloi javën që shkoi takimin me temë "Botimet shqipe në Malin e Zi", me praninë e të ftuarit të nderit, akademikut dhe poetit Pavle Goranoviq, ambasadorit të Republikës së Malit të Zi në Tiranë, z. Dusan Mrdovic, si dhe pjesëmarrjen e studiuesve, poetëve, studentëve...

FORUM NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE: "BOTIMET SHQIPE NË MALIN E ZI"

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, në bashkëpunim me Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Malit të Zi, zhvilloi javën që shkoi, më datë 6 qershor, takimin me temë "Botimet shqipe në Malin e Zi", me praninë e të ftuarit të nderit, akademikut dhe poetit Pavle Goranoviq, ambasadorit të Republikës së Malit të Zi në Tiranë, z. Dusan Mrdovic, si dhe pjesëmarrjen e studiuesve, poetëve, studentëve etj. I organizuar në formën e një forumi, drejtuar nga prof. dr. Persida Asllani, drejtore e BKSH-së, poeti dhe bibliografi dr. Gazmend Krasniqi, përkthyesi Dimitrov Popoviq si dhe studiuesja Liridona Sinishtaj, ky aktivitet erdhi si një takim mbi një temë të rëndësishme të kulturës e letërsisë shqipe, atë të botimeve shqipe në Malin e Zi. Në fjalën e saj përshëndetëse, drejtoresha e BKSH-së, Persida Asllani, u shpreh se "ne jemi dy vende në fqinjësi shumë të gjatë, të shtresëzuara në linja dhe në periudha nga më të hershmet, dhe gjithnjë kemi mbetur peng i nevojës për të njohur më mirë dhe për të kuptuar e pranuar më mirë njëri-tjetrin. Rruga më e sigurt dhe më cilësore është edhe ajo e artit, veçanërisht e letërsisë. Zërat dhe pena e poetëve dhe shkrimtarëve tanë, qasja që i bëjnë thellësisë njerëzore dhe identitetit tonë kombëtar, por edhe privat, janë ato që na bashkojnë, por edhe na pasurojnë". Duke theksuar rëndësinë e botimeve shqipe në Malin e Zi, znj. Asllani shtoi se "fokusi i parë kanë qenë autorët shqiptarë të Malit të Zi, mënyra se si ata zhvillojnë letërsinë e tyre në raport me letërsinë shqipe, por, mbi të gjitha, në raport me kulturën dhe jetën e librit në Malin e Zi. Vlen të theksojmë se botimet shqipe në Mal të Zi prej shumë vjetësh po realizohen përmes një programi ambicioz, në kuadër të njohjes së letërsisë shqipe dhe autorëve shqiptarë". Ndërkohë, ambasadori i Malit të Zi në Tiranë, z. Dusan Mrdovic, duke falënderuar për organizimin e këtij aktiviteti, u shpreh se "është shumë e rëndësishme njohja e punës që bëhet në fushën e botimeve në gjuhën shqipe. Në dekadat e fundit është arritur të përkthehen në gjuhën shqipe të gjitha tekstet shkollore për shkollat fillore dhe të mesme. Një qasje e rëndësishme është ruajtja dhe kultivimi i traditave, historisë dhe kulturës së tyre, në një kontekst të fqinjësisë së mirë, si një urë e fortë lidhëse".

Në vijim të forumit, dr. Gazmend Krasniqi, duke vlerësuar krijimtarinë e poetit malazez Pavle Goranoviq, si dhe vëllimin poetik "Stinët e humbura" (Onufri, 2013), sjellë në gjuhën shqipe nga përkthyesi dhe poeti Dimitrov Popoviq, theksoi se "si te çdo poet post-modern, poetika e kësaj krijimtarie nuk priret nga ngjarjet apo sendet e shenjtëruara, siç jemi mësuar me poezinë e traditës, por me aspektet më të pavëna re të përditshmërisë, që vjen e behtë dhe e papritur, edhe pse jo bërtitëse". Sipas Krasniqit, "poeti nuk e synon goditjen e drejtpërdrejtë që vjen nga një numër i reduktuar vargjesh: ai ia ka besuar veten fjalëve, magjia e të cilave zbulon ngadalë, pa patetikë, madje me autoironi, se si, me një barok të mbajtur prej frerësh, e "larta" dhe "e ulëta", si kategori estetike, kanë shkuar paralel në gatimin e produktit poetik. Një poezi e emancipuar dhe emancipuese, që ndërton një raport besueshmërie me lexuesin, na flet për një prani – gjithmonë e ngarkuar me kujtesë – diku pranë derës, në pritje të daljes, sigurisht në mënyrën më të fisnikëruar. Edhe pse e ardhur në mënyrën më të nëndheshme, kjo ide synon lexuesin që do t'i ngulet në kujtesë. Siç e kërkon poezia e mirë, pas leximesh të përsëritura. E cila, fundi i fundit, është vetë sfida e letërsisë së mirë".

Ndërsa studiuesja Liridona Sinishtaj në ligjëratën e saj u ndal në zhvillimin e letërsisë shqipe në Mal të Zi, parë nën ndikime historike, gjeografike dhe kulturore. "Përfshirja e të gjitha botimeve shqip në Mal të Zi është e pamundur për një forum, prandaj do të merremi me letërsinë dhe autorët e saj duke u nisur nga disa piketa, të cilat i konsiderojmë të rëndësishme për të njohur dhe për të kuptuar procesin letrar në këtë letërsi", - vuri në dukje Sinishtaj. Ajo u ndal në botimet e para shqipe, shkrimtarët shqiptarë në Mal të Zi si dhe rastin e atyre shkrimtarëve shqiptarë që krijuan në Kosovë, rolin e shoqërive botuese si dhe ndryshimet e dhjetëvjeçarit të fundit.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua botime shkollore. Përkthyesi Dimitrov Popoviq, njëherazi dhe redaktor për botimet në gjuhën shqipe në Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore në Podgoricë (Mal i Zi), solli një panoramë të përgjithshme të botimeve shkollore shqip, arsimit shqip në Malin e Zi si dhe projektet për të ardhmen.

Forumi u shoqërua edhe me një ekspozitë me botime nga fondi arkivor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, e cila pasqyroi një pjesë të botimeve të autorëve shqiptarë të Malit të Zi si dhe botime në gjuhën shqipe të autorëve malazezë.

BOTIM I RI

ERMIR HOXHA ME STUDIMIN "HISTORIA E ARTIT SHQIPTAR 1858-2000"

Një punë 10 vjeçare e studiuesit të arteve pamore, Ermir Hoxha është finalizuar me botimin "Historia e Artit Shqiptar 1858 – 2000", duke paraqitur epokën moderne të historisë së vendit tonë, apo atë periudhë kur produkti artistik realizohej nga shqiptarët për shqiptarët, duke u shtrirë nga viti 1858 (data e fotografisë së parë në realitetin vendas, dhe si i tillë imazhi i parë realist) deri në dekadën e fundit të shekullit XX. "Metoda e Realizmit Socialist, termi i hasur rëndom në çdo artikull të botuar në vitet '50, kishte përfituar një fizionomi të improvizuar, që në vitet e para të pasluftës... Të çorientuar ata improvizuan mbi shembujt e veprave që pëlqeheshin në konkurse, apo që lakoheshin në debate e shumta në shtypin e kohës, apo kopjuan deri diku shembujt klasikë të artit sovjetik.", shkruan në këtë studim Ermir Hoxha, duke vijuar më tej se: "Edhe pse të qartë mbi direktivat shtetërore, vështirësitë që ata hasën për materializimin e kësaj metode, qenë serioze. Shteti shqiptar, i vetëdijshëm për këtë dhe si pasojë e mungesës së specialistëve në shumë fusha të artit (dhe



të shkencës), kërkoi me ngulm edukimin e një brezi të zgjedhur nxënësish, të cilët do të dërgoheshin me studime të larta në vendet e bllokut lindor. Në një dekadë, rreth 4500 prej tyre, janë përzgjedhur sa nga cilësia, aq edhe nga shtresa shoqërore dhe biografia, u dërguan si misionarë në vendin nënë të komunizmit proletar dhe vendeve të tjera satelite.", është shprehur Hoxha për mediat. Nëpërmjet këtij studimi, Hoxha prek mediumin e pikturës, skulpturës, fotografisë, grafikës dhe karikaturës dhe ato mediumet e tjera që u zhvilluan në periudhën e fundme si instalacionet dhe videot. Libri ka 328 faqe, rreth 500 ilustrime dhe është i ndarë në 5 periudha studimore përkatësisht: Pjesa e parë; Realizmi romantik në prag të shekullit XX (1858 – 1912). Pjesa e dytë; Institucionalizimi i artit në shtetin e ri shqiptar (1920 – 1939). Pjesa e tretë; Arti pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1961); Pjesa e katërt; Realizmi socialist në Shqipëri (1961 – 1985). Pjesa e pestë; Në kërkim të kohës së humbur (1985 – 2000) Rëndësia e këtij projekti qëndron në faktin që në realitetin shqiptar (të pas viteve '90) nuk ekziston ende një Histori e Artit Shqiptar i plotë apo i pjesshëm dhe si e tillë domosdoshmëria e tij është tejet evidente. Për institucionet artistike të çdo niveli, të cilat ende nuk ka asnjë botim të ngjashëm, shpjegues e analitik, si dhe për gjithë ata të rinj apo studiues, që duan të dinë më shumë për artin e vendit të tyre, si në studime krahasuese, apo përqasje fenomenologjike. Ky botim mbetet sipërmarrja më serioze për të unifikuar, periodizuar dhe vlerësuar trashëgiminë kulturore të arteve pamore të vendit tonë. Ai propozohet si mëse i përshtatshëm në volum dhe përqasje dhe brenda gjithë parametrave shkencor për të arritur objektivat dhe rezultatet e pritura. Ermir Hoxha, autori i librit "Historia e Artit Shqiptar 1858-2000" është pedagog i lëndës së Historisë së Artit Shqiptar në Universitetin e Arteve dhe menaxher i galerisë FAB në të njëjtin institucion.

Interes i jashtëzakonshëm i lexuesve të Kosovës për librin shqip. Në pesë ditët e mbajtjes së Panairit të Librit në Prishtinë, mjaft aktivitete e promovime kanë paraqitur autorët shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, ku edhe janë ndarë çmimet nga Shoqata e Botuesve

PANAIRI I LIBRIT NË PRISHTINË, SPROVA ME LEXUESIT

Shkrimtari Fatos Kongoli u shpall autori i vitit nga Shoqata e Botuesve

Lexuesi i Kosovës është sprovues, ka kuriozitetin e njohjes, komunikimit, edhe pse shumë emra nga Shqipëria nuk i kanë dëgjuar më parë. Për këtë fenomen, jo pak herë personalitete të kulturës dhe letërsisë janë shprehur se mes nesh vazhdon të jetë e pamjaftueshme njohja, kur as gazetat nuk këmbehen, sidomos kultura ende nuk ka integritetin e natyrshëm. Edhe pse flitet shqip dhe jemi një gjuhë e kulturë, edhe pse agjendat politike përpiqen të ndërtojnë kalendarë vjetorë, sërish mes nesh njohja është e paktë. Por lexuesi është befasues. Në Panairin e 21-të të Librit që u mbajt në Prishtinë prej datës 5 deri më 9 qershor, i vetmi organizim që përmbush komunikimin, rreth 100 botues nga të gjitha trevat shqiptare janë paraqitur me botimet e reja, sidomos me autorë shqiptarë të rinj e të afirmuar. Duke mos përjashtuar përkthimet, ky panair, ashtu si edhe ai i Tiranës, vëmendjen e ka mbi botimet letrare, ku edhe treguesin se çfarë botohet në arealin shqiptar e kanë dëshmuar vlerësimet, çmimet vjetore që ndahen. Shoqata e Botuesve të Kosovës në këtë edicion e shpalli Fatos Kongolin shkrimtar të vitit me veprën "Gënjeshtarë të vegjël". Kurse për shkrimtarin e huaj të vitit, çmimi iu nda Jacques Baudouin-it për veprën "Lindja e Demokracisë". Organizatorët thanë se panairi i sivjetshëm ka tejkaluar pritshmëritë.

Në mesin e shumë çmimeve të tjera që u ndanë, ishte edhe çmimi për letërsinë për fëmijë, të cilin e fitoi autorja Anila Kruti me veprën "Flutura e Majit". Për publicistikën, çmimi iu dha Mirela Oktrovës me veprën "55 ditë". Kurse, në kuadër të poezisë dhe prozës më të mirë, çmimet iu ndanë Ismail Sylës dhe Kim Mehmetit. Ndërsa stenda më e vizituar këtë vit, sipas organizatorëve, është "Botë Art".

Në universin e përditshmërisë

Letërsia shqipe nuk është vetëm ajo e temave të mëdha rapsodike me bajlozë, por edhe një art i fjalës që depërton tek e thjeshta me pafund histori të zakonshme. Aty ku heronj janë të rëndomtit dhe përditshmëria e tyre. Ndryshe nga protagonisti i konsumuar me heroizëm e bëma të mëdha gjatë letërsisë njëlineare të kohës së regjimit komunist, tani bota e njerëzve të "vegjël" shfaqet me një dimension të ri të psikologjisë njerëzore. Një situatë pa dramaticitete ideologjike dhe ku gënjeshtra bëhet aq e kudondodhur në përditshmërinë e njerëzve, shkruan sot *Koha Ditore*.

Romani më i ri i Fatos Kongolit, "Gënjeshtarët e vegjël", ka si antihero personazhin Alpi, i cili rrëfen në vetën e parë dashuritë e tij, zhgënjimet, si dhe një univers të tërë përditshmërie ku njerëzit gënjejnë njëri-tjetrin.

"Në dukje mund të jetë një temë e vogël, por e trajtuar në mënyrë të jashtëzakonshme nga Kongoli, me psikologjinë e njeriut të thjeshtë dhe jo me heronj të mëdhenj", - ka thënë në fjalën e saj drejtoresha e shtëpisë botuese "Toena", Irena Toçi. Shkrimtari Fatos Kongoli u shpreh për *Koha Ditore* se "jam një çikë pesimist në rolin që mund të luajë letërsia. Kjo është pasqyrim i ndërgjegjes kombëtare. Politikanët le të bërtasin sa të duan, por nuk e bëjnë ndërgjegjen kombëtare. Ata s'janë ndërgjegjja kombëtare, megjithëse kanë frenat e gjithçkaje në dorë. Ndaj, duan apo nuk duan, ata nuk janë ndërgjegjja e kombit. Ndërgjegjja e kombit janë shkrimtarët dhe artistët. Këtë s'ma heq askush nga mendja".

Shoqata e Botuesve

Me recitimin e vargjeve të Sevasti Qiriazit nga Safete Rugova, u bë hapja e edicionit të 21-të të Panairit të Librit në Prishtinë, ku organizatori Edon Zeneli, përfaqësuesi i Shoqatës së Botuesve të Kosovës, u shpreh se, me gjithë sfidat e panumërta, lexuesi është i vetëdijshëm dhe më i pranishëm se kurrë. Duke kërkuar përkrahjen nga personat me ndikim, institucionet publike, u kërkua që të veprohet për bibliotekat në vendin tonë, që janë në gjendje letargjie, ku rrjedhimisht lexuesi nuk është i pranishëm.

Kurse kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ishte i kënaqur me përkthimin e letërsisë botërore në gjuhën shqipe. "Kemi pjesëmarrës një numër të madh të shkrimtarëve tanë që janë sot këtu dhe jemi të kënaqur që Panairi i 21-të përkon me çlirimin e Prishtinës. Bëj thirrje që qytetarët ta frekuentojnë sa më shumë Panairin dhe të blejnë libra, sepse leximi është baza e kulturës së çdo kombi", - tha Ahmeti ku bëri hapjen e Panairit. Veçanti e Panairit të 21-të është prezenca e shkrimtarit shqiptar Fatos Kongoli, i cili merr pjesë në këtë ngjarje pas një kohe. "Jam shumë i prekur për fjalët e mira që u thanë për mua. Ndihem i lumtur që jam në Prishtinë, ku edhe do ta prezantoj romanin tim më të ri", - tha ai për mediat.

Edhe një emër i njohur i letërsisë bashkëkohore ishte pjesëmarrës në hapje. Shkrimtari i shquar francez Juan Asensio u shpreh se ishte i lumtur që gjendet në mesin e shqiptarëve dhe shihte shumë dashuri për kulturën e librin në kryeqytetin kosovar. Dashuria e shqiptarëve për librin i ka lënë mbresa atij dhe është gjë e bukur që romani i tij është sjellë në gjuhën shqipe. Kurse ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, i lumtur për pjesëmarrjen në këtë ngjarje, u shpreh: "Kudo në Kosovë festohet 20-vjetori, ndërsa këtu festohet 21-vjetori. Është diçka unike që Kosova gjatë kohës së luftës festoi hapjen për herë të parë të Panairit të Librit shqip, që sipas Minxhozit është ngjarje madhore historike. Ai thotë se libri, krahas pushkës, solli lirinë që kemi sot. Ndërsa shkrimtari Daut Demaku në fjalimin e tij foli për ligjin e krijimit me të cilin tha se u mor gjatë. "Jeta ecën veç përpara, libri është një mundësi që çel dritë në rrugën e ecjes përpara. Krejt ata që i doni, ftoni, le ta marrin librin, të bashkëjetojnë me të, e jo me thashetheme që janë jo vetëm kot, por janë edhe në kundërshti me ligjin e jetës që ec përpara", - përfundoi ai. Në kuadër të panairit janë mbajtur shumë aktivitete.

"Letërsia nuk mund të jetë informuese, didaktike apo indoktrinuese, por mund të lërë një gjurmë të vërtetë në frikërat e tua, mund të hapë dritare në mendjen tënde, të të bëjë të vësh në dyshim diçka për të cilën s'ke menduar kurrë më parë. Dhe nganjëherë kjo është po aq e rëndësishme sa një informacion aktual, madje edhe më i besueshëm".

SAMANTA SCHWEBLIN

ZBULOJ ERRËSIRËN PËRMES LETËRSISË

Intervistoi Bethanne Patrick

Si është Berlini sot?

Krejtësisht dimëror! Ka tri ditë që bie borë e cila ka mbuluar gjithçka. Është pamje e këndshme. Më pëlqen Berlini në ditë si këto.

Pse u shpërngulët për të jetuar në Berlin?

Për shkak të një burse njëvjeçare nga bashkia e Buenos Airesit, diçka vërtet e mrekullueshme dhe një gjest bujar. Në fund të saj ishte e vështirë për t'u rikthyer në jetën reale. Megjithatë, erdha në Gjermani me të dashurin tim i cili është argjentinas dhe ndërsa isha e zënë me të shkruarit, ai bëri atë që bëhet zakonisht kur je i papunë: hapi një bar. Ndodhet në Kreuzberg.

A e bën atmosfera në Berlin më të lehtë për të krijuar art?

Në të vërtetë, është shumë ndryshe nga Buenos Airesi, në aspektin strukturor. E dua shumë Buenos Airesin, por kur erdha këtu, kuptova që mund të punoj më pak dhe të kem më shumë kohë për të shkruar. Këtu mund të organizoj seminare mbi shkrimin tri herë në javë dhe të ardhurat më mjaftojnë për të jetuar.

Më tregoni pak për rrugën tuaj për t'u bërë shkrimtare. Si janë ditët tuaja, tani, si shkrimtare, edhe pse jo shkrimtare me kohë të plotë?

Gjithmonë më tërhiqnin librat dhe rrëfimet. Nisa të shkoj në disa seminare letrare kur isha rreth të shtatëmbëdhjetave dhe s'kam reshtur së shkruari që atëherë. Në Argjentinë gjysma e shkrimtarëve organizojnë seminare në shtëpitë e tyre. Si pjesëmarrëse, ishte mahnitëse të mësoja në dhomën e ndenjjes së shkrimtarëve të mi të parapëlqyer, të kisha mundësi të hyja në bibliotekat e tyre dhe të zbuloja një jetë që i përkushtohet të shkruarit nga kaq afër. Tani, ndërsa jetoj në Berlin, dy herë në javë organizoj seminare mbi shkrimin në dhomën e ndenjjes, duke vazhduar traditën. Ishte një zbulim befasues për mua të shihja se sa shumë njerëz shkruajnë letërsi në Spanjë dhe në Gjermani, dhe e bëjnë kaq seriozisht. Pjesën tjetër të javës jam një shkrimtare me kohë të plotë.

A ka më rëndësi romani? Nëse po, si dhe për kë?

Epo, ka shumë rëndësi për mua. Mendoj se serialët televizivë, lojërat dhe media në përgjithësi kanë ndryshuar mënyrën se si rrëfejmë histori. Por librat do të mbeten. Teknologjia ka ndryshuar të gjitha artet e tjera: pikturën, teatrin, kërcimin, kinemanë, muzikën. Por letërsia është një proces krejtësisht intim ndërmjet zërit të shkrimtarit dhe mendjes së lexuesit, është diçka kaq e natyrshme dhe e fortë, sa e vetmja gjë që teknologjia mund të ndryshojë, është mbështetja e tij, formati, për shembull, nëse lexojmë një libër të shtypur apo një libër elektronik. Por kjo s'e ndryshon zemrën e letërsisë.

Cilët janë autorët që nuk i lexojnë, por duhet të lexohen nga amerikanët?

Më vijnë kaq shumë emra në mendje, sa është gati e pamundur t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Mësova të shkruaj duke lexuar letërsinë e Amerikës së Veriut, e dashuroj letërsinë tuaj, por kam ndjesinë që nëse një vend lexon vetëm letërsinë që krijon vetë, ai do të mbetet pa oksigjen. E di që këtë vit dy shkrimtare të tjera argjentinase do të përkthehen në anglisht: Leila Guerrero, një kronikane e mprehtë, dhe tregimet e Mariana Enriquez të cilat me subjektet e tyre rrëqethëse dhe të llahtarshme të bëjnë të zgjohesh në mes të natës. Shumë gjëra po ndodhin me shkrimtaret bashkëkohore në Amerikën Latine. Ndoshta kjo do të ishte një pikë e mirë nisjeje.

Cilat janë romanet që do të donit t'i kishit shkruar?

Nganjëherë mendoj "Njeriu i tretë" i Flen O. Brajenit (Flann O'Brien) dhe nganjëherë "Shpikja e Morelit" e Adolfo Bioy Casares.

Cilin autor po lexoni tani? A lexoni letërsi ndërsa shkruani, apo lexoni poezi ose libra joletrarë?

Miqtë dhe shkrimtarët janë udhëheqësit e mi më të besuar për sa u përket leximeve. Unë gjithmonë mbaj parasysh rekomandimet që më japin njerëz që më duken interesantë. Nganjëherë s'janë shkrimtarë dhe librat e tyre të parapëlqyer nuk janë letërsi, por ide të mëdha që mund të burojnë prej saj.

Meqë ra fjala tek idetë e mëdha, libri juaj është theksuar nga shumë kritikë se nuk është një libër i zakonshëm. A ishte kjo e qëllimshme? A synonit të shkruanit diçka të ndryshme?

Është e vështirë t'i përgjigjesh, por do të përpiqem. Për mua, krijimi i tensionit është një nga gjërat më të rëndësishme gjatë leximit dhe të shkruarit. Kam nevojë për këtë tension si lexuese, por gjithashtu kam nevojë për të kur po shkruaj ose kur s'mundem të vijoj të punoj me librin. Kur e filloj një libër, që nga ideja më e parë, me të vërtetë që kam nevojë të ndiej që ajo që po bëj është diçka vërtet e re, sepse nëse nuk është, nuk është e mundur që ajo që po shkruaj të marrë vëmendjen time. Kur isha e vogël dhe ende s'kisha mësuar të shkruaja, e kisha zakon t'i rrëfeja histori nënës sime. Isha afërisht pesë ose gjashtë vjeçe dhe çdo natë i tregoja histori. Më kujtohet që zbuloja ndjesinë që isha në gjendje të prekja me të vërtetë dikë tjetër me historitë e mia dhe çka është edhe më e mira, nëse sajoja diçka vërtet dramatike, kjo do të thoshte se mund ta shndërroja historinë dhe të

"Doja të jepja një ngjyresë të veçantë, vërtet të veçantë, të kësaj ideje që nëse do të vijë fundi i botës, ai do të fillojë nga nëna. Lidhja me Davidin është ajo lidhje që ekziston kur gjërat bëhen aq të trishtuara sa të përmbledhësh të gjitha fatkeqësitë e botës, kur çdo gjë është e tmerrshme...

tërhiqja vëmendjen ndërkohë që e doja kaq shumë atë. Nuk janë të shumta çastet në jetë kur dikush tjetër do të të dëgjojë, kur ti arrin të rrokësh plotësisht vëmendjen e tij. Është një ndjenjë magjepsëse dhe kur jam duke shkruar, përpiqem ta përjetoj këtë çast.

Le të flasim pak për rolin e kafshëve në "Largësi shpëtimi", për rolin e kuajve dhe insekteve.

Dua ta tregoj këtë lloj fuqie që ato kanë, gjithashtu ngaqë Davidi ka informacion të cilin ne nuk e kemi, e kam fjalën për ne lexuesit dhe për Amandën. Ai di shumë për vdekjen dhe në një vend ku njerëzit po vdesin nga kimikatet, edhe kafshët po vdesin. Davidi e ka këtë fuqi për të ndihmuar ata që po vdesin. Ai e ka këtë marrëdhënie me të gjitha gjërat në botë mes jetës dhe vdekjes, të gjitha gjërat që janë në një lloj purgatori.

Jam prind dhe më pëlqeu shumë ideja e "largësisë së shpëtimit", tërheqja që Amanda thotë se ndien sa herë që e bija është larg saj.

Doja të jepja një ngjyresë të veçantë, vërtet të veçantë, të kësaj ideje që nëse do të vijë fundi i botës, ai do të fillojë nga nëna. Lidhja me Davidin është ajo lidhje që ekziston kur gjërat bëhen aq të trishtuara sa të përmbledhësh të gjitha fatkeqësitë e botës, kur çdo gjë është e tmerrshme, drama e vogël e dy ose tri personazheve mund të jetë me të vërtetë e rëndësishme. Mund të jetë fillimi i diçkaje me të vërtetë të thellë, ku një pyetje e thjeshtë të ndihmon të dish ku fillon e keqja dhe nëse e di se ku është e keqja, mund ta luftosh atë. Kur kjo ndodh, çdo gjë bëhet e rrezikshme. Kjo është arsyeja që "largësia e shpëtimit" prishet: çdo gjë në botën ku jeton Amanda është e rrezikshme.

Pse përqendrohet ky roman te nënat dhe jo te baballarët?

Mendoj se kjo është e lidhur me jetën time. Në kujtesën time, burrat në familjen time ishin të dobishëm në shumë mënyra, si për shembull duke bartur gjëra të rënda, ndërsa kur nuk shkonte diçka që lidhej me shpirtin, emocionet, ishin gratë ato që merreshin me këtë gjë. Kjo jo ngaqë burrat s'donin t'ia dinin, por sepse s'e kuptonin dhe s'mund të dukeshin sikur po merreshin me gjëra të tilla. Në fund të "Largësi shpëtimi", kur të gjitha gratë kanë ikur, të vetmit që mbeten janë dy baballarë të cilët duan të përkujdesen, por që nuk arrijnë të krijojnë vërtet komunikim.

Pse Davidi këmbëngul t'i thotë Amandës që "kjo s'ka rëndësi" për të vijuar ecjen përpara? Çfarë do të thotë kjo?

Kur po shkruaja librin, shumë herë kisha ndjesinë që Davidi i kërkon Amandës të vazhdojë përpara, që ai në të vërtetë po më kërkonte mua ta bëj këtë, duke më thënë të vijoja me këtë mënyrë të ndryshme të shkruari. Një metaforë interesante për atë që ia vlen dhe nuk ia vlen ta thuash! M'u desh kohë të gjeja zërin e Davidit. Shkrova afërisht dymbëdhjetë fillime të ndryshme, prej pesë ose gjashtë faqesh secili, duke u përpjekur të gjej zërin e rrëfimtarit. Në fund të atij procesi dëgjoj zërin e Davidit që flet me Amandën. Në fillim mendova që dialogu i tyre do të ishte pjesë e romanit. Pastaj kuptova që dialogu ishte romani. Ishte vetë historia që më tregoi se si ta rrëfeja.

Sëmundja dhe shkatërrimi global janë probleme globale. A mund të ndodhnin ngjarjet e romanit tuaj diku tjetër, apo mund të ndodhnin vetëm në Amerikën Latine?

Kjo histori mund të ndodhte kudo. Në të vërtetë, hera e parë që dëgjova për pesticidet dhe pasojat e tyre të tmerrshme ishte nëpërmjet një dokumentari mbi këtë temë në Francë. Por, para së gjithash, për shkak të korrupsionit Amerika Latine ka ligjet dhe marrëveshjet më të këqija me kimikatet. Dhe Argjentina, sidoqoftë, është një nga importueset më të mëdha të sojës, një nga produktet më të lidhura me pesticidet. Ne e shpërndajmë këtë sojë në të gjithë botën, është baza e një pjese të madhe të ushqimit tonë. Soja është gjithçka: biskotat, peshqit e ngrirë, buka, supat dhe të gjitha llojet e miellit, madje edhe e akullores!

Si shihet situata e tanishme politike amerikane në Gjermani, Europë dhe në pjesën tjetër të botës?

Mendoj se ne të gjithë jemi vërtet të shqetësuar. Këtu në Gjermani, rrethi im i miqve nuk është i lumtur me Donald Trump-in si presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara, megjithëse e djathta europiane e simpatizon atë. Dhe si një latino-amerikane ju siguroj që e djathta populiste mund të jetë vërtet e rrezikshme.

Ai i flet një libër si yti politikës moderne më shumë se një libër joletrar? Pse po ose pse jo?

Po, i flet politikës moderne, por në një mënyrë të ndryshme. Letërsia nuk mund të jetë informuese, didaktike apo indoktrinuese, por mund të lërë një gjurmë të vërtetë në frikërat e tua, mund të hapë dritare në mendjen tënde, të të bëjë të vësh në dyshim diçka për të cilën s'ke menduar kurrë më parë. Dhe nganjëherë kjo është po aq e rëndësishme sa një informacion aktual, madje edhe më i besueshëm.

Përktheu nga anglishtja Granit Zela

RYAN HOLIDAY

Autori bestseller i ***Pengesa është rrugëdalja***

EGOJA ËSHTË ARMIKU

Lufta për të mposhtur kundërshtarin tonë më të fortë

Minerva